

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5572
E hënë, 10 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Minatorët e 'Trepçë'-s sërish paralajmërojnë grevë

FAQE 9



PRESIDENTI I SERBISË, ALEKSANDAR VUÇIQ, KA PËRFUNDUAR VIZËN DYDITORE NË KOSOVË, E CILA ËSHTË PRITUR ME REAGIME TË NDRYSHME

Drenica e ndal 'shëtitjen' e Vuçiqit nëpër Kosovë



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka dështuar t'i takonte të dielën serbët e fshatit Banjë të Skenderajt, pasi qytetarët e kësaj ane kanë bllokuar me automjete, goma dhe drunj, të gjitha rrugët që çojnë në këtë fshat

me shumicë serbe. Pas këtyre veprimeve kryeministri Ramush Haradinaj ia ka tërhequr lejen presidentit serb për ta vizituar këtë vend. Moslejimi i kësaj vizite ka nxitur reagime vendore dhe ndërkombëtare. Pak

kohë pas dështimit për t'i takuar serbët e fshatit Banjë, Vuçiqi u është drejtuar serbëve nga sheshi kryesor në Mitrovicë të Veriut, të cilëve u ka thënë se Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës

TË DIELËN ËSHTË BËRË NJË VIT KUR KUVENDI I KOSOVËS KA VOTUAR QEVERINË HARADINAJ

FAQE 3

Njëvjetori i Qeverisë Haradinaj, mes kritikave dhe lëvdatave

Qeveria e Kosovës të dielën ka shënuar njëvjetorin e votimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Puna njëvjeçare e saj është vlerësuar në mënyrë të ndryshme nga njohësit e rrethanave politike. Politologu Belul Beqaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se gjatë kësaj qeverisje kanë ndodhur aventurat më të rrezikshme brenda dhe jashtë Kosovës. Sipas tij, sukcesi më i madh i Qeverisë është paralizimi i opozitës. Ndërsa analisti politik Behxhet Shala ka thënë për "Epokën e re" se Qeveria Haradinaj s'ka mundur të bëjë më shumë meqë është bal-



lafaqar me presion nga të gjitha anët. Ai e ka quajtur sukses të kësaj Qeverie zgjidhjen e demarkacionit dhe liberalizimin e vizave



Kurti:
Të rritet pjesëmarrja e grave në Lëvizjen Vetëvendosje dhe politikë

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

ÇFARË 'VIZITE' ËSHTË ARDHJA E VUÇIQIT NË KOSOVË

F. 11

Jakup KRASNIQI



KUSH DO TA BËJË VETTINGUN NË SHQIPËRI, RAMA DHE BASHA?

F. 11



Bedri ISLAMI

MBI 250 PACIENTË NË DITË KËRKOJNË NDIHMË NË EMERGJENCË

F. 7

META E THAÇI DREKUAN SË BASHKU NË DURRËS

F. 7

EKONOMI



RRITET NUMRI I BIZNESEVE TË REJA

F. 9

PUNËTORËT E POSTËS, NË GREVË

F. 8

SPORT



KOSOVA DËSHIRON VETËM FITORE NË 'FADIL VOKRRI'

F.16

KUQEZINJTË PËR FITORE NË SKOCI

F.16

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vuesha, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666


Senatori Johnson fton qytetarët e Maqedonisë të votojnë në referendum

SHKUP, 9 SHTATOR - Senatori amerikan Ron Johnson u ka bërë thirrje qytetarëve të Maqedonisë që të dalin dhe të votojnë në referendumin e 30 shtatorit.

Pas takimit në Shkup me kryeministrin Zoran Zaev, senatori Johnson tha se marrëveshja e Prespës është mënyra e vetme për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. "Është me rëndësi të

veçantë për Maqedoninë dhe Greqinë që të zgjidhin çështjen e emrit. Kemi dy liderë të guximshëm, dy kryeministra të cilët janë gjendur në pozitë të vështirë. Ne sigurisht që duam ta mbështesim zgjidhjen e këtij problemi dhe kjo është mënyra e vetme për Maqedoninë që të anëtarësohet në NATO. Do të doja që Maqedonia të bëhet anëtarja e 30

e NATO-s. Kjo është shumë e rëndësishme për NATO-n dhe për sigurinë e rajonit e Ballkanit dhe Maqedonisë. I inkurajoj të gjithë qytetarët që të dalin dhe të votojnë në referendum, pa marrë parasysh nëse pajtohen ose jo me marrëveshjen. Ata duhet të dalin të votojnë, dhe t'u tregojnë liderëve se çfarë ndiejnë", deklaroi Johnson.



Pavarësia e Maqedonisë, nën hijen e referendumit

27 vjet më parë Maqedonia arriti pavarësinë nga ish-shteti komunist jugosllav. Që atëherë, maqedonasit synim kishin krijimin e shtetit unitar dhe inkuadrimitin e tij në NATO dhe BE, por kjo nuk u arrit edhe 27 vjet nga pavarësia për shkak të problemeve me fqinjët, në veçanti me Greqinë, për shkak të mosnjohjes së emrit Maqedoni

SHKUP, 9 SHTATOR - Maqedonia shënoi 27-vjetorin e pavarësisë nga ish-shteti komunist jugosllav. Për dallim nga ish-republikat e tjera, Maqedonia ndarjen e arriti pa luftë, ndërsa themelet e shtetit të ri u vendosën në referendumin më 8 shtator të vitit 1991. Referendumi ishte bojkotuar nga shqiptarët për shkak të injorimit të kërkesës së tyre për barabarësi. Që atëherë, maqedonasit synim kishin krijimin e shtetit unitar dhe inkuadrimitin e tij në NATO dhe BE, por kjo nuk u arrit edhe 27 vjet nga pavarësia për shkak të problemeve me fqinjët, në veçanti me Greqinë për shkak të mosnjohjes së emrit Maqedoni.

Maqedonia tani ndodhet para një referendumi të ri, për mbështetjen ose jo të marrëveshjes me fqinjin jugor për një emër ti, Maqedonia e Veriut. Duke bërë një paralele mes dy referendumeve, ish-kryetari i Kuvendit të parë, Stojan Andov, thotë se ata kanë lidhshmëri mes tyre, apo referendumi për emrin është vazhdimësi e aspiratave për forcimit e shtetit, si pjesë e familjes euroatlantike. "Referendumi i vitit 1991 është momenti më i madh historik për ne, pasi arritëm pavarësinë, por atëherë nuk e kishim menduar se do të bëjnë një

shtet të izoluar, por shtet që do të ishte pjesë e familjes së shteteve evropiane. Tani ky referendum ka një lidhje organike me referendumin për pavarësi, pasi paraqet vazhdimësi të aspiratave tona të para 27 vjetëve, pra vazhdimësi të kurorëzimit të synimit tonë që të jemi pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian", thotë Stojan Andov.

Ai vlerëson pozitivisht edhe qëndrimin e shqiptarëve dhe të bashkësive tjera etnike që tani mbështesin referendumin, që sipas tij forcon unitetin e shtetit. Por, Andov nuk e komenton bojkotin që shqiptarët i kishin bërë referendumi për pavarësinë e shtetit për shkak të, siç kishin deklaruar, mospërbushjes së kërkesës kryesore të tyre për barabarësi në shtetin që po krijohet pas ndarjes nga ish - Jugosllavia.

Ish-kryetari i Kuvendit kritikon kreun e shtetit, Gjorge Ivanov por edhe opozitën për qëndrime, sipas tij, aspak të logjikshme, por që beson se nuk do të kenë sukses në zbrapsjen e vendit nga integritet euroatlantike. "Qëndrimet e presidentit janë të gabuara, mendoj se ai njeri nuk arriti të gjendet në rrethanat e reja për të ardhmen e vendit. Mendoj se një



situatë të njëjtë është edhe opozita, e cila nuk e mbështet marrëveshjen. Por, konsideroj se kundërshtimet e tyre nuk janë aq të fuqishme sa të pengojnë suksesin e referendumi. Qëndrimet e tilla pengojnë zhvillimin e vendit, perspektivën dhe mirëqenien e qytetarëve. Në rast se procesi dështon, do të bëhet shumë keq për vendin, por assesi nuk dua të mendoj se do të vijmë në një situatë të tillë", vlerëson Andov.

Ndryshe, Vehdi Xhemali, historian dhe ish-deputet në përbërjen e parë parlamentare, mendon ndryshe nga ish-kryetari i Kuvendit të Maqedonisë. Ai thotë se është i madh dallimi mes referendumi të parë për pavarësi dhe këtij të tanishmit për çështjen emrit. Në të parin, sipas Xhemalit, shqiptarët e bojkotuan për shkak të injorimit të kërkesave të tyre, andaj edhe ai nuk përkujtohet

asnjëherë nga personalitetet shqiptare. "Dallimi është shumë i madh pasi atëherë punohej pastër për interesin tonë shqiptar, për një shtet të barabartë mes maqedonasve dhe shqiptarëve. Por, atëkohë maqedonasit nuk ishin të gatshëm të pranojnë një barazi të plotë, prandaj ne për këtë arsye e bojkotuam referendumin. Ndërkohë, sot, kemi të bëjmë me një referendum tjetër, që ka edhe karakter ndërkombëtar, prandaj shqiptarët janë të interesuar që të ketë sukses, pasi duan që të kenë një siguri edhe më të madhe si politike, ekonomike, sociale dhe me anëtarësimin e vendit në NATO dhe BE shqiptarët mendoj se do të kenë barazi të plotë nën mbikëqyrjen e institucioneve evropiane e ndërkombëtare", thotë Xhemali.

Duke komentuar pakënaqësitë nga qarqe të ndryshme, në veçan-

ti të diasporës shqiptare, por edhe të opozitës, e cila ka vërejtje mbi marrëveshjen me Greqinë, për shkak se, sipas saj, shumë çështje do të mbeten pa u definuar, si ajo e gjuhës shqipe, Xhemali pranon se këto të drejta nuk janë arritur që nga pavarësia e Maqedonisë. Mirëpo, ai beson se ato do të gjejnë zgjidhje me inkuadrimitin e vendit të institucioneve evropiane. "Ne nuk i kemi arritur, por besoj se me këtë referendumin e ri, apo përmes tij dhe me ndërmjetësimin ndërkombëtar apo lëvizjen e tyre në mesin tonë, do të kemi një situatë më reale ku do të mbisundojë barabarësia mes dy popujve apo e drejta në çdo aspekt shtetëror", thekson Xhemali duke shpresuar në suksesin e referendumi, pasi, sipas tij, nëse ndodh e kundërta, Maqedonia nuk do të ketë të ardhme.

Tsipras: Nuk ekziston çështja çame

ATHINË, 9 SHTATOR - Në një deklaratë të dielën, kryeministri grek, Alexis Tsipras, ka folur për negociatat me Shqipërinë, duke u shprehur se bisedimet janë në një klimë pozitive. Tsipras ka theksuar se Greqia e mbështet hapjen e negociatave të anëtarësimin për

Shqipërinë. "Negociatat po zhvillohen në nivel ministrash të jashtëm të dy vendeve. Ato janë çështje të vështira, por bisedimet janë në klimë pozitive. Që Greqia ta mbështesë hapjen e kapitujve të negociatave të integritetit duhet të kryejë një sërë reformash dhe

premtimesh që ka bërë qeveria shqiptare", tha kryeministri grek. Kryeministri grek foli edhe për çështjen çame, duke thënë se ajo nuk ekziston. "Disa përipiqen ta fusin nga 'dritarja' çështjen çame. Nuk ekziston kjo çështje", tha Tsipras.



Të dielën është bërë një vit kur Kuvendi i Kosovës ka votuar Qeverinë Haradinaj

Njëvjetori i Qeverisë Haradinaj, mes kritikave dhe lëvdatave



Qeveria e Kosovës të dielën ka shënuar njëvjetorin e votimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Puna njëvjeçare e saj është vlerësuar në mënyrë të ndryshme nga njohësit e rrethanave politike. Politologu Belul Beqaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se gjatë kësaj qeverisje kanë ndodhur aventurat më të rrezikshme brenda dhe jashtë Kosovës. Sipas tij, suksesi më i madh i Qeverisë është paralizimi i opozitës. Ndërsa analisti politik Behxhet Shala ka thënë për "Epokën e re" se Qeveria Haradinaj s'ka mundur të bëjë më shumë meqë është ballafaquar me presion nga të gjitha anët. Ai e ka quajtur sukses të kësaj Qeverie zgjidhjen e demarkacionit dhe liberalizimin e vizave

Mendoj se kjo Qeveri po të kishte bashkëpunim të mirë me opozitën dhe ta përjashtonte nga loja Listën Serbe, puna e saj do të ishte më e mirë në të gjitha drejtimet", është shprehur ai. Shala e ka quajtur sukses të kësaj Qeverie zgjidhjen e demarkacionit me Malin e Zi dhe procesin e liberalizimit të vizave. "I ka bërë disa lëvizje që tjerët nuk i kanë bërë. Për shembull, e ka çuar përpara procesin e demarkacionit me Malin e Zi dhe e ka ofruar edhe një hap procesin e liberalizimit të vizave. Pastaj ka rregulluar çështjen e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Dhe, së fundi, ka marrë iniciativën për pastrimin e Kosovës", ka theksuar ai. Shala ka vlerësuar se Qeveria Haradinaj ka dështuar në politikën e jashtme dhe në reciprocitetin me Serbinë. "Kjo Qeveri ka një minus sepse nuk ka ndërmarrë asgjë lidhur me fryrjen e listave të veteranëve, numri i të cilëve ka arritur mbi 60 mijë. Ka dështuar në politikën e jashtme dhe në procesin e njohjeve. Ministri Pacolli nuk është

marrë me çështjet e Kosovës, por kryesisht me çështje private. Kjo Qeveri ka dështuar edhe në vendosjen e reciprocitetit me Serbinë. Nëse ata lejojnë politikanët e Kosovës të hyjnë në Serbi, edhe Kosova duhet t'i lejojë politikanët serbë të hyjnë në Kosovë. Por, jo në Kosovë të hyjë kush dëshiron nga Serbia, kurse asnjë politikan i Kosovës nuk mund të shkojë në Serbi apo ta vizitojë Luginën e Preshevës", ka vlerësuar Shala. Sipas tij, gjatë këtij viti Kuvendi ka qenë jofunksional dhe, si i tillë, nuk ka mundur ta mbikëqyrë punën e Qeverisë. "Opozita e ka penguar në vazhdimësi punën e Qeverisë duke mos i interesuar asgjë, por vetëm shkuarja sa më parë në zgjedhje të reja. Qeveria po ballafaqohet me kërkesa dhe greva. Të gjithë po kërkojnë vetëm para dhe përfitime dhe pothuajse askush nuk mendon të japë një kontribut për Kosovën. Kuvendi nuk ka funksionuar dhe, si i tillë, nuk ka mundur ta mbikëqyrë Qeverinë. Është një situatë jo e mirë, megjithatë janë disa përmirësime krahasuar me qeveritë e kaluara", ka thënë Shala.

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Qeveria e drejtuar nga kryeministri Ramush Haradinaj të dielën ka mbushur një vit prej kur është votuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 61 vota për dhe një abstenim. Dymbëdhjetë muaj qeverisës të këtij kabineti qeveritar janë komentuar të dielën në mënyra të ndryshme nga analistët politikë. Me këtë rast, politologu Belul Beqaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se gjatë periudhës njëvjeçare të Qeverisë Haradinaj kanë ndodhur aventurat më të rrezikshme

brenda dhe jashtë shtetit të Kosovës. Ai ka theksuar se suksesi më i madh i kësaj Qeverie ka qenë paralizimi i opozitës, ndërsa dështimi më i madh, sipas tij, është paaftësia që ta gllabërojë së paku gjysmën e buxhetit për vete. "Pas pavarësisë së Kosovës e konsideroj se ky është viti ku kanë ndodhur aventurat më të rrezikshme brenda dhe jashtë Kosovës. Suksesi më i madh i kësaj Qeverie është paralizimi i opozitës, ndërsa dështimi më i madh është paaftësia që ta gllabërojë së paku gjysmën e buxhetit për vete", ka deklaruar Beqaj. Ndërsa analisti politik Behxhet

Shala ka thënë për "Epoka e re" se Qeveria Haradinaj s'ka mundur të bëjë më shumë gjatë këtyre dymbëdhjetë muajve meqë, sipas tij, është ballafaquar me presion nga të gjitha anët. "Qeveria Haradinaj nuk mund të bëjë asgjë më tepër sepse nuk ka përkrahje. Kjo Qeveri që i ka 61 vota dhe varet nga Lista Serbe nuk ka mundur të bëjë më tepër sepse në vazhdimësi është ballafaquar me presionin e Listës Serbe dhe të opozitës. Është vazhdim i qeverive të tjera dhe nuk ka ndonjë dështim të madh sikur që nuk ka pasur ndonjë punë të madhe sepse nuk ka pasur hapësirë për të punuar.

Oarkullojnë monedha të falsifikuara në Prishtinë

PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Të shtunën në mbrëmje një person nga Prishtina ka raportuar se dikush i ka lëshuar atij në dorë 100 euro të falsifikuara. Sipas

Policisë së Kosovës, ankuesi ka raportuar se derisa ishte duke punuar në lokalin e tij, nga një person i panjohur ka pranuar një kartëmonedhë prej 100 eurosh,

që dyshohet të jetë e falsifikuar. Rasti është duke u hetuar dhe autoritetet ende nuk kanë arritur ta identifikojnë ndonjë të dyshuar.



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka përfunduar vizën dyditore në Kosovë, e cila është pritur me reagime të ndryshme

Drenica e ndal 'shëtitetjen' e

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka dështuar t'i takonte të dielën serbët e fshatit Banjë të Skenderajt, pasi qytetarët e kësaj ane kanë bllokuar me automjete, goma dhe drunj, të gjitha rrugët që çojnë në këtë fshat me shumicë serbe. Pas këtyre veprimeve kryeministri Ramush Haradinaj ia ka tërhequr lejen presidentit serb për ta vizituar këtë vend. Moslejimi i kësaj vizite ka nxitur reagime vendore dhe ndërkombëtare. Pak kohë pas dështimit për t'i takuar serbët e fshatit Banjë, Vuçiqi u është drejtuar serbëve nga sheshi kryesor në Mitrovicë të Veriut, të cilëve u ka thënë se Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Dita e dytë e vizitës së presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Kosovë, nuk ka shkuar ashtu siç ishte planifikuar. Pas vizitës së liqenit të Ujmanit, dita e dytë e qëndrimit të presidentit serb në Kosovë ishte paraparë të filloonte me vizitën e tij në fshatin Banjë të Skenderajt, por qindra qytetarë nga rajoni i Drenicës kishin bllokuar rrugët që çojnë në këtë fshat me shumicë serbe. Në orët e para të mëngjesit të së dielës degët e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së në Skenderaj, të mbështetura edhe nga politikanë lokalë, kishin ftuar qytetarët të dalin në rrugë për t'ia pamundësuar Vuçiqit shkuarjen në fshatin Banjë.

Duke iu përgjigjur kësaj ftese, qytetarët e rajonit të Drenicës kanë bllokuar rrugën, duke vënë automjete dhe pengesa të ndryshme për ta pamundësuar qarkullimin e kryeministrit serb. Qytetarët mbanin pankarta të ndryshme me mbishkrime "Vuçiqi nuk kalon", "Kërko falje për krimet e bëra", e slogane të ngjashme.

Edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i ishte bashkangjitur protestës. Ai ka thënë se presidenti serb nuk mund të kalojë përmes rajonit të Drenicës pa kërkuar falje për krimet e bëra nga forcat serbe në Kosovë gjatë luftës së fundit. "Janë 15 mijë të vrarë nga lufta, 1 600 persona të zhdukur, 128 persona të zhdukur nga komuna jonë, kështu që me plot të drejtë po e kundërshtojmë vizitën e tij.

Vizita e tij është një provokim dhe ringjallje e vitit '98 dhe '99", është shprehur Jashari. Përveç qindra qytetarëve të këtij rajoni, protestës i ishin bashkangjitur edhe kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ministri i Financave, Bedri Hamza dhe deputetë e zyrtarë

të tjerë të lartë nga ky rajon. Duke i parë këto zhvillime, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka tërhequr lejen që presidenti serb ta vizitojë këtë fshat, duke thënë se këtë po e bën për shkaqe sigurie. "Siguria e qytetarëve është mbi të gjitha. Kam tërhequr lejen e dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme për vizitë të presidentit serb në zonën e Drenicës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Ndalimi i Vuçiqit ka nxitur reagime

Moslejimi i vizitës së presidentit serb në fshatin Banjë ka nxitur reagime ndërkombëtare dhe vendore. Maja Kocijançiq, zëdhënëse e BE-së, ka thënë se shpreh keqardhje për vendimin e autoriteteve të Kosovës. "Kërkojmë nga të gjithë përgjegjësit për rendin që ta garantojnë sigurinë dhe kalimet (qarkullimin) e lirë gjatë ditës", ka thënë ajo, duke shtuar se paqja duhet të ruhet. "Angazhimi i plotë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë së njerëzve në Kosovë dhe popullit serb, mençuria dhe qetësia, janë ato që nevojiten tash", ka thënë Kocijançiq. Sipas saj, vizita e Vuçiqit ka kaluar qetë me angazhimin e të gjithë aktorëve përgjegjës, deri në momentin e bllokimit të rrugës për vizitën në Banjë të Skenderajt. Të menjëhershme kanë qenë edhe reagimet e vendorëve.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka dalë kundër bllokimit të rrugës nga ana e banorëve dhe veteranëve të Drenicës, në të njëjtën kohë e ka përshëndetur vendimin e Qeverisë së Kosovës për t'ia ndaluar vizitën Vuçiqit në Banjë të Skenderajt. "Qeveria e Republikës së Kosovës ditë më parë kishte miratuar kërkesën për vizitën e presidentit të Serbisë në Kosovë, duke përfshirë itinerarin e saktë. Por, për shkak të rrethanave të reja të krijuara dhe ruajtjes së sigurisë së qytetarëve dhe të vet delegacionit të presidentit serb, sot Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për anulimin e vizitës së tij në fshatin Banje. Si president i Kosovës e mirëkuptoj plotësisht reagimin e qytetarëve të Drenicës, të cilët kanë shprehur revoltën e tyre të arsyeshme kundër një vizite të tillë. Kjo tregon se plagët e dhimbjes dhe luftës janë ende shumë të freskëta", ka shkruar presidenti në profilin e vet në "Facebook", duke mos u pajtuar me bllokimin e rrugëve. "Megjithatë, në kohën kur jemi duke bërë përpjekje për paqe dhe pajtim, protestat dhe bllokimi i rrugëve aspak nuk na ndihmojnë. Prandaj, e kuptoj edhe zhgënjimin e banorëve të komunitetit serb në fshatin Banje për pamundësinë e realizimit të kësaj vizite. Të gjithë duhet të përmbahemi dhe të tregojmë kulturë minimale njerëzore të mirëkuptimit dhe komunikimit njerëzor. Ne duhet të dimë të ngrihem mbi



Vuçiqit nëpër Kosovë



vetveten, mbi plagët dhe dhimbjet e shumta. Duhet ta bëjmë këtë për hir të paqes dhe pajtimit', ka shkruar Thaçi.

Ndaj kësaj ngjarje ka reaguar edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli. "Konsideroj se demonstrimi mbi pendën e Ujmanit ka qenë demonstrim i pastër i logjikës së hegjemonisë politike, po ashtu edhe kundër çdo rregulli të sigurisë, pasi nuk ka asnjë lloj praktike demokratike që garanton masa të sigurisë për të mbajtur konferencë shtypi mbi pendë. Gjithsesi, vizita e tij konsideroj se u bë mirë që ndodhi, sepse edhe një herë u dëshmuar se liderët e Serbisë po e vazhdojnë traditën e Sllobodan Millosheviqit", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook", duke mos përmendur fare protestën e cila ia pamundësoi presidentit serb shkuarjen në fshatin Banjë. "Tentimet për të na bllokuar në ecjen tonë, vizitat e shpeshta me tone provokuese në këta 19 vjet, na dëshmojnë se ne duhet të mendojmë dhe angazhohemi edhe më shumë për forcimin e shtetit të Kosovës. Ne tani jemi në një fazë tejet të rëndësishme të dialogut me Serbinë. Zhvillimet e këtyre dy ditëve lidhen me fazën finale të dialogut dhe duhet të na bëjnë bashkë të gjithëve që të jemi sa më të përgatitur për sfidat që na presin", ka shkruar ai.

Ndërsa Lëvizja Vetëvendosje përmes një komunikate për media ka vlerësuar se dhënia e

lejes për Vuçiqin ia rrit Serbisë pretendimet për Kosovën. "Institucionet e Kosovës asnjëherë nuk kanë treguar seriozitet sa herë që udhëqësit serbë paralajmërojnë vizita në Kosovë. Që prej dhënies së lejes për presidentin serb Aleksandar Vuçiq, pushteti në Kosovë po tregon se është i gatshëm të lëshojë pe dhe të bëjë kompromise me Serbinë që i paguan shteti e populli ynë. Kjo leje është e paligjshme, është jolegjitime, e dëmshme për të tashmen dhe e rrezikshme për të ardhmen", është thënë në komunikatën e LV-së.

Vuçiqi: Nuk e njohim pavarësinë e Kosovës

Megjithatë, në ditën e dytë të vizitës në Kosovë, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka mbajtur flijimin e tij në pjesën veriore. Me këtë rast, para një numri të konsiderueshëm të serbëve, ai ka thënë se Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës. "Jua them, se ata që deklarojnë se unë duhet ta pranoj pavarësinë e Kosovës deri në fund të vitit, kjo është gënjeshtër", ka thënë Vuçiq. Sipas tij, krejt për çka ai po angazhohet është një zgjidhje

kompromisi dhe zgjidhje paqësore. "Kur u thonë se dua ta ndryshoj kufirin, nuk po ua thonë të vërtetën", është shprehur Vuçiqi, duke shtruar më pas pyetjet, sipas tij, plot dilema. "Ku është kufiri sot? Në fakt, unë dua t'i ndryshoj të drejtat e juaja dhe t'jua mundësoj të gjitha drejtat që ju takojnë në botën e qytetëruar", ka nënvizuar ai. Ai ka deklaruar se ka sjellë me vete plane konkrete për investime në dhjetë komunat e Kosovës të banuara me shumicë serbe.

Sa i përket kohës se kur mund të arrihet një marrëveshje me shqiptarët, ai ka thënë se nuk dihet.

Vuçiqi nuk e ka përjashtuar mundësinë që pas një kohe, qoftë edhe pas 50 vjetësh, serbët dhe shqiptarët të jetojnë në fqinjësi dhe miqësi me njëri-tjetrin. "Nuk është vizioni im për një Kosovë pa shqiptarë apo edhe më keq, një Kosovë pa serbë", është shprehur Vuçiqi, duke tërhequr vërejtjen se vizioni i tij nuk mbështetet në mite, por në realitet.

Policia e Kosovës ka njoftuar se delegacioni me presidentin serb, Aleksandar Vuçiq, është kthyer nga rajoni i veriut të Mitrovicës drejt pikës kufitare në Jarinjë, dhe i njëjti ka lëshuar territorin e Republikës së Kosovës të dielën rreth orës 13:50. Ky institucion ka treguar edhe për mbarëvajtjen e vizitës së presidentin serb. "Lidhur me vizitën e lejuar të presidentit serb në vendin tonë, Policia e Kosovës përmes planifikimeve operationale ka ndër-marrë masat e nevojshme policore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në vend, si dhe përcjelljes së eskortës dhe ofrimit të sigurisë së delegacionit", është thënë në komunikatën e policisë. Policia ka përmendur edhe organizimin dhe bllokimin e rrugës në rajonin e Drenicës për të protestuar kundër vizitës së presidentit serb në këtë rajon. Policia ka mohuar pretendimet e presidentit serb dhe të medieve serbe se gjatë bllokimit të rrugëve për në fshatin Banjë ka pasur edhe të shtëna me armë. Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka përgëzuar zyrtarët e Policisë së Kosovës, të cilët me punë dhe përkushtim po garantojnë ambient të sigurt dhe të qetë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Presidenti serb vizitën dyditore në Kosovë e ka nisur të shtunën, ku kishte vizituar liqenin e Ujmanit. Mbi digën e këtij liqeni ai ka mbajtur një fjalim, ku i ka deklaruar pretendimet e Serbisë për këtë liqen. Fillimisht, institucionet vendore ia kishin refuzuar presidentit serb vizitën në liqenin e Ujmanit por, pas presionit ndërkombëtar, Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës e ka lejuar këtë vizitë.



ÇFARË 'VIZITE' ËSHTË ARDHJA E VUÇIQIT NË KOSOVË



Jakup KRASNIQI

Kosova, në koordinim me faktorin ndërkombëtar, më 17 shkurt 2008 e ka shpallur pavarësinë e vet dhe nga atëherë deri më sot e kanë njohur mbi 115 vende të Botës. Pra, Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe ka shumë njo-

hje ndërkombëtare, bile ka shumë shtete në Botë që nuk kanë qaj shumë njohje. Por, natyrisht ato nuk e kanë pasur pengesën e vetos ruse në Këshillin e Sigurimit. Nuk ka asnjë dyshim, Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Prandaj, vizitat e zyrtarëve të lartë të shtetit duhet ta kenë vijën protokollare që dihet botërisht. Vizita e Vuçiqit nuk e përmban asnjë element protokollar në mes të shteteve dhe, si e tillë që është, është jashtë çdo protokoll dhe nuk është dashur që të ndodhë.

Sigurisht se, për të mos ndod-

hur kjo, nuk është dashur të zhvilloheshin bisedimet politike të Brukselit në mes të Kosovës e Serbisë dhe pa këto bisedime nuk do ta kishim as fusnotën e as Listën Serbe në institucionet e Kosovës e cila është bartëse e politikës serbe në jetën institucionale të Kosovës. Po të ishte vizitë ardhja e Vuçiqit në Kosovë, ai së pari do të takohej me zyrtarët e lartë të shtetit të Kosovës dhe kjo nuk ka ndodhur. Atëherë, a mund të quhet vizitë ardhja e tij në Kosovë dhe kryesisht në pjesën e Kosovës që e pretendon ta aneksojë? Ose, thënë më saktë, atë

pjesë që ai dhe bandat e tij e bëjnë ligjin. Natyrisht se përgjegjësia është si e atyre që i udhëhiqen ato bisedime dhe e atyre që i mbështeten ato. Kjo nuk është vizitë, është diversion në një pjesë të shtetit tonë, është shkelje e sovranitetit të shtetit dhe e gjithë kjo maskaradë e përcjellë nga Policia e Kosovës. Sovranitetin e shtetit e garanton Kushtetuta si akt më i lartë i shtetit?! Dhe krejt kjo maskaradë u bë me lejen e atyre që do të duhej ta mbronin sovranitetin. E keqja është se kjo tanimë është bërë rrugë e rrahur! Kjo ishte arsyeja që Luani

nuk lejoi që mustakët e tij të bëheshin autostradë e minjve! Prandaj, kjo nuk është vizitë, por është hapi i parë për t'ia rrëmbyer Kosovës një hapësirë më vitale të saj! Kjo ardhje është më e rrezikshme sesa treni nacionalist i para pak viteve dhe i cili që penguar të hynte në Kosovë. Pse sot u veprua ndryshe? Apo janë duke u realizuar dëshirat e presidentit tonë, për ndryshimin e kufijve të Republikës sonë?!

Tani kur presidenti ynë do ta vizitojë hapësirën e Kosovës Lindore që do t'i bashkohet Kosovës?

Kashtanjeva, fshati që po rilind

**EPOKA
ERE**

Ismail REXHEPI

KASHTANJEVË, 9 SHTATOR - Një ndër fshatrat më të thellë malore në rrethinën e Ferizajt është fshati Kashtanjevë. Ky fshat kodrinor-malor, me një pamje piktoreske, njihet më shumë si vend i blegtorëve që, prej kafshëve shtëpiake, kanë dominuar delet. Mirëpo, nuk kanë qenë të paktë edhe ata banorë që janë marrë me artizanale të ndryshme të cilat ua ka imponuar përditshmëria në këtë katund.

Para luftës Kashtanjeva ishte përplot me banorë. Pas luftës ai u rrallua aq shumë sa që mbetën fare pak shtëpi. Pra, fshati u shkretua pa banorë. Kashtanjeva ka përjetuar barbarinë serbe brenda 100 vjetëve duke u djegur i tëri dy herë radhazi, siç u dogj edhe në luftën e fundit nga hordhitë serbe.

Kur humbën shpresat se në Kashtanjevë më nuk mund të



ketë të paktën një njeri, po ndodh mrekullia. Themi kështu, se në ditën që vizituam këtë fshat pamë gjallëri të madhe, banorë të shumtë të kthyer, të cilët më parë ishin larguar. Madje Kashtanjevës po i vijnë ditë të lumtura pasi biznesmenë të shumtë janë duke investuar në fushën e turizmit në këtë fshat.

Po ashtu, kudo shihen shtëpi të reja të të gjitha llojeve. Tashmë Kashtanjeva është një fshat i dëshiruar nga njerëz të të gjitha anëve të vendit, pra

është i njëjti interesim si për Prevallën e Prizrenit.

Kashtanjevës po i vijnë ditë të mira falë asfaltimit të rrugës para pak vitesh nga Qeveria e Kosovës. Sot shumë njerëz duan shtëpi në Kashtanjevë.

U larguam nga ky fshat që na la mbresa të mëdha për tërë kohën sa qëndruam aty. Me një natyrë të mrekullueshme që vetëm Zoti ka mundur ta krijojë të tillë. Me male, fusha, kodra, burime uji, me kroje, me pemë pothuajse të të gjitha llojeve, nga mollët deri në lajthi.



Dogana kap 500 mijë copë cigare të kontrabanduara

PODUJEVË, 9 SHTATOR (ER) - Njësitë e Doganës së Kosovës, gjatë një aksioni të organizuar me qëllim të parandalimit të kontrabandës me duhan, kanë arritur të kapin sasi të konsiderueshme të këtij produkti. Pas sigurimit të informatave përmes rrugëve operative, të shtunën rreth orës 20:30 në rajonin e Podujevës ekipet e Doganës kanë ndaluar një kamionë që transportonte kafshë, i cili tentonte të dilte nga territori i Kosovës në pikëkalimin kufitar të Merdares.

Pas kontrollit në hapësira të fshehura (të ndërtruara për kontrabandë) janë gjetur 480 000 copë cigare "Chesterfield" dhe 20 000 cope cigare "Pall Mall", që të gjitha me banderola të Maqedonisë (gjithsejtë 50 pako të mëdha). Pas gjetjes së kësaj sasive, në konsultim me prokurorin kompetent, malli është sekuestruar, ndërsa i dyshimti është intervistuar dhe dërguar në paraburgim. Ndaj të dyshimit është proceduar kallëzimi penal për shmangie të pagesës së taksave rreth 30 000 mijë euro.



Mbi 250 pacientë në ditë kërkojnë ndihmë në Emergjencë

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Frekuenca ditore e pacientëve vetëm në Klinikën Emergjente në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është rreth 250 pacientë. Kjo Klinikë aktualisht i ka 19 shtretër. Kanë qenë, nga muaji janar e deri në muajin gusht të këtij viti, mbi 37 mijë raste që kanë kërkuar ndihmë mjekësore emergjente. Drejtori i kësaj Klinike, Basri Lenjani, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, krahasuar me vitet para-

prake, numri i përgjithshëm i atyre që kanë kërkuar ndihmë mjekësore në këtë institucion është rritur. "Në Klinikën Emergjente për janar-gusht ndihmë mjekësore kanë kërkuar mbi 37 mijë raste. Prej tyre, 70 përqind u takojnë sëmundjeve akute jetë-kërcënuese, kurse 30 përqind u takojnë gjendjeve aksidentale në komunikacion. Nga numri i përgjithshëm, në Klinikën Emergjente nga aksidentet në komunikacion kanë qenë

2 635 njerëz, prej tyre 12 të vdekur. Po ashtu, kemi numër të shtuar që kërkojnë shërbime emergjente mjekësore, ku vazhdon avazi i vjetër dhe mosrespektimi i sistemit të referimit nga spitalet rajonale, duke iu referuar rasteve që mund t'i menaxhojnë ata. Derisa rastet që kërkojnë tretman specialistik mund t'i dërgojnë pa problem në Klinikën Emergjente, ku ne i pranojmë ato raste për trajtim", ka thënë Lenjani.



Klinika Emergjente ka një sipërfaqe prej 507 metrash katrorë dhe ka 19 shtretër

gjë që, sipas Basri Lenjanit, nuk i përmbush nevojat dhe kërkesat e pacientëve.



Kurti: Të rritet pjesëmarrja e grave në Lëvizjen Vetëvendosje dhe politikë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Lëvizjes Vetëvendosje synon përfshirjen sa më të madhe të grave në vendimmarrje dhe politikë. Kështu u tha të dielën në tubimin mobilizues të organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje me temë "Gratë në Lëvizje". Kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se fokusi kryesor i kësaj

partie është numri më i madh i grave në bazën e tyre pasi, sipas tij, gruaja e drejton ndryshe partinë dhe shtetin. "Ne duhet ta rrisim pjesëmarrjen e grave në politikë. Nuk është zgjidhja e mjaftueshme vetëm te përzgjedhja e një përqindje lart në hierarki, pra te kuotat përfaqësuese, sepse shpesh kemi parë edhe në vendin tonë edhe në vende të tjera se, kur një grua ka arritur në pozita më të larta, situata e

përgjithshme për gratë nuk ka ndryshuar. Për mendimin tim, ne duhet të punojmë më shumë për të rritur më shumë anëtarësimin e grave. Pra, fokusi ynë kryesor duhet të jetë transformimi i bazës. Siç e tha edhe sekretarja jonë, aktualisht vetëm çdo i katërti anëtar në Lëvizjen Vetëvendosje është grua dhe kjo duhet të ndryshojë shumë dhe shpejt", ka thënë ai. Sipas Kurtit, gratë po i qëndrojnë larg poli-

tikës pasi kjo aktualisht është politikë patriarkale. Duke i përmendur deklaratat e para nga gratë për barazi gjinore, nënkryetarja Fatmire Mullhaxha-Kollçaku ka thënë se që nga viti 1971 ende po duhet të diskutohet për barazi gjinore. Sipas saj, synimi i partisë është të jenë 50/50 sa i takon barazisë gjinore. "Është e qartë që tubime të tilla ne nuk i mbajmë shpesh sepse ne nuk e shohim të ndarë

rolin e gruas në shoqëri, por historikisht ne nuk mund ta mohojmë se gruaja ka qenë e privuar nga shumë të drejta që u kanë takuar burrave", ka thënë Mullhaxha-Kollçaku. Drejtuesja e sekretariatit të Gruas në Lëvizjen Vetëvendosje, Nazlie Balaj, ka thënë se të gjitha gratë me profesione janë të përkushtuara t'i ndihmojnë njëra-tjetrës për t'u fuqizuar në shoqëri.

Meta e Thaçi drekuan së bashku në Durrës

DURRËS, 9 SHTATOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, është takuar të dielën në Durrës për një drekë pune me presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Meta përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka njoftuar se rritja e mëtejshme e shkëmbimeve

të gjithanshme midis dy vendeve është një prioritet i përbashkët. "Forcimi i stabilitetit rajonal dhe perspektivës evropiane të rajonit është qëllim i përbashkët. Ndaj është me rëndësi vazhdimi i dialogut për normalizimin përfundimtar të marrëdhënieve

Kosovë - Serbi që do të garantojë jo vetëm njohje reciproke midis dy vendeve si dhe të ardhmen e tyre në BE, por dhe një bashkëjetesë të përhershme midis shqiptarëve dhe serbëve në interes të gjeneratave të ardhshme", ka shkruar presidenti Meta.



Rritet numri i bizneseve të reja

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Edhe pse në Kosovë afaristë të ndryshëm vazhdimisht ankohen për ambient të pafavorshëm për të bërë biznes dhe që rrethanat aktuale ekonomike nuk lejojnë fitim të kënaqshëm kjo, siç duket, nuk ka ndikuar aspak te qytetarët, për dëshirën dhe iniciativën e tyre për të hapur biznese të reja.

Vetëm gjatë këtij viti më shumë se 2 600 biznese të reja janë regjistruar në gjithë territorin e Kosovës apo rreth 18 për qind më shumë krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e regjistrimit të bizneseve, sipas ekspertëve të ekonomisë, ndodh për shkak të procedurave të lehta të regjistrimit dhe nuk mund të ketë ndonjë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në

vend.

Por, ajo çka mbetet shqetësuese për ta, është fakti se aktiviteti më i preferuar afarist mbetet dukshëm sektori i tregtisë para sektorit të prodhimit. Sipas raportit të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë, thuhet se nga numri i përgjithshëm i bizneseve të reja, 723 janë në sektorin e tregtisë, 300 në sektorin e prodhimit, kurse ndërtimtaria me 260 biznese të reja.

Në sektorin e tregtisë, në muajin shkurt të këtij viti, një lokal të vogël ka hapur edhe Besa në qytetin e Fushë-Kosovës. "Unë kam hapur një dyqan të vogël në Fushë-Kosovë. Është dyqan tregtar, shes produkte ushqimore me të cilat furnizohem nëpër dyqane më të mëdha.

Kam regjistruar biznesin, nuk kam pasur problem. Fillimisht, nuk ka shumë punë, por pres përmirësim në të ardhmen", thotë ajo.

Por, eksperti për çështje ekonomike, Naser Grajçevci, thotë se numri i regjistrimit të bizneseve të reja është për shkak të procedurave të lehta për regjistrimin e bizneseve dhe nuk është produkt i rritjes ekonomike në Kosovë.

Grajçevci, i cili ka qenë drejtor i Agjencisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, thotë se institucionet e Kosovës duhet të merren në mënyrë më substanciale me çështjen e themelimit të bizneseve të reja. "Nuk është një parametër me të cilin ne do të matnim nëse kemi rritje dhe

zhvillim ekonomik. Njerëzit shkojnë e bëjnë regjistrimin e bizneseve të reja për qëllime të ndryshme qoftë si biznese start-up, apo tani në Kosovë është edhe një paraqitje e bizneseve të mëdha, të cilat themelojnë biznese 'bija' po biznese të vogla, për interesa në kuadër të bizneseve të tyre, për biznese të mëdha", thotë Grajçevci.

Institucionet kompetente në vend, vlerëson ai, duhet të krijojnë ambient më të leverdishëm në sektorin e prodhimit, mënyrë kjo e vetmja që mund ta zvogëlojë edhe varshmërinë e Kosovës nga importi i produkteve të huaja. Sipas Grajçevcit, vitet e fundit ka pasur ndarje të subvencioneve dhe donacioneve në sektorë të ndryshëm, mjete këto që në treg, sipas tij, nuk po vërehen. "Me këto fonde

po bëhen improvizime. Institucionet e Kosovës nuk kanë mënyrë të saktë se ku duhet të shkojnë mjetet e taksapaguesve kosovarë. Kosova çalon nga aspekti i kapacitetit institucional të institucioneve vendore për të identifikuar mirë se ku duhet të shkojnë paratë e taksapaguesve, apo këto bëhen me qëllim", shton ai.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, më shumë se 2 500 biznese të regjistruara kanë të punësuar nga 1 deri në 4 punëtorë, deri në nëntë punëtorë kanë 60 ndërmarrje, kurse deri në 20 punëtorë kanë 25 biznese. Sa i përket shtrirjes së ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave, vazhdon të mbizotërojë komuna e Prishtinës, Ferizajt dhe Prizrenit.



Shutterstock

Punëtorët e postës, në grevë

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Sindikata e Punëtorëve të Postës së Kosovës ka njoftuar se nga sot (e hënë) punëtorët e postës do të hyjnë në grevë të përgjithshme, e cila, sipas tyre, nuk do të ndalet deri në realizimin e kërkesave të tyre. Sipas njoftimit të kësaj sindikate, në sportelet e Postës së Kosovës nuk do të ofrohet asnjë shërbim. "Greva nuk do të ndalet deri në realizimin e pagave për të gjithë

punonjësit e Postës së Kosovës, garantim me shkrim nga menaxhmenti, bordi dhe Qeveria e Kosovës që ekzekutimi i pagave në muajt e ardhshëm do të bëhet brenda afatit ligjor. Qeveria e Kosovës duhet të kryejë urgjentisht obligimin ligjor ndaj Postës, rimbursimin e humbjeve në Shërbimin Universal Postar. Qeveria t'i mundësojë Postës t'i marrë shërbimet që i ka

secili operator postar në rajon dhe më gjerë (pensionet dhe skemat e ndryshme sociale, shpërndarja e faturave për shërbime publike si dhe themelimi i Post-Bankës)", është thënë në njoftim e sindikatës.

Më tej thuhet se greva do të pasohet edhe me veprime të tjera sindikale deri në realizimin e plotë të kërkesave të punëtorëve të Postës së Kosovës.



Minatorët e 'Trepçë'-s sërish paralajmërojnë grevë



Qeveria e Kosovës më 31 korrik ka themeluar grupin punues teknik për vlerësimin e të gjitha aseteve që janë në pronësi të ndërmarrjes shoqërore "Trepça", por ende nuk është mbajtur asnjë takim i këtij grupi punues. Këtë e ka konfirmuar për gazetën "Epoka e re" kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të "Trepçë"-s, Shyqyri Sadiku, i cili ka paralajmëruar sërish grevë në rast se nuk do të plotësohen kërkesat e tyre

torëve në Stantërg. Kurse Fidaïm Sahiti, i cili e përfaqëson Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në këtë grup punues, kur është pyetur nëse është mbajtur ndonjë takim i këtij grupi, ai ka dhënë këtë përgjigje. "Grupi punues teknik për vlerësimin e të gjitha aseteve që janë në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore 'Trepça' Sh. A. ende nuk ka mbajtur takimin e këtij grupi për shkak se grupi punues teknik është formuar më 6. 9. 2018 dhe për një periudhë kaq të shkurtër nuk është e mundur të shqyrtohen çështjet sociale të ngritura nga Sindikata e Minatorëve të 'Trepçë'-s", ka thënë Fidaïm Sahiti për gazetën "Epoka e re". Ndërkaq sa i përket emërimit të anëtarëve në grupin punues, ai ka thënë se ky grup do të përbëhet nga Shkumbim Asllani, këshilltar ligjor; Fidaïm Sahiti, shërbimi gjeologjik i Kosovës; dy përfaqësues nga Sindikata e "Trepçë"-s, Halil Qela dhe

Ramadan Ukaj; një përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Gazmend Abrashi; dhe një përfaqësues nga Oda Ekonomike e Kosovës, Rea Kryeziu. Ndërsa kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës, Shyqyri Sadiku, ka konfirmuar për gazetën "Epoka e re" se nuk kanë marrë zyrtarisht asnjë ftesë për takim në këtë grup punues. Ai ka thënë se në emër të minatorëve të "Trepçë"-s do t'i shkruajë ministrit të MZHE-së, Valdrin Lluka. Sa iu përket çështjeve sociale për të cilat më herët insistonin që të hyjnë në draftstatutin e "Trepçë"-s, ai ka thënë se tani janë të pajtimit që për çështjet sociale të bëhet një ligj i veçantë. "Ne ishim pajtuar të formohet grupi punues, ku njëri grup ishte paraparë për asetet e 'Trepçës'-s, tjetri për çështjet sociale. Po ashtu, kërkonim që pika kryesore të ishte miniera e Zjaqës që është zonë e interesit të veçantë. Edhe për këtë ende nuk janë formuar grupet punuese dhe zyrtarisht

nuk kemi marrë ndonjë shkresë", ka deklaruar ai. Sadiku ka thënë se në rast që në afatin e paraparë kohor nuk do të përmbushen kërkesat e tyre, atëherë ata do të hyjnë sërish në grevë. "Në rast se nuk përmbushen kërkesat tona, përsëri do të hyjmë në grevë. Apeloj te Qeveria që të bëjnë më shumë në këtë drejtim pasi çështjet politike janë duke ndikuar të zvarriten kërkesat tona", ka thënë Sadiku.

I vetmi studim për të gjitha resurset natyrore të Kosovës që është bërë në vitin 1992, ka vlerësuar se potenciali material i "Trepçë"-s mund të jetë 85 miliardë dollarë amerikanë. Kombinati metalurgjik "Trepça" gjendet në komunën e Mitrovicës. Sektorët e tij gjenden në pjesën veriore dhe atë jugore të qytetit. Përveç aseteve në Kosovë, 31 prona të këtij kombinati gjenden në republikat e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë këtu fabrika, zyra dhe objekte të tjera.

**EPOKA
ERE** **Albulena S.MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Qeveria e Republikës së Kosovës më 31 korrik ka themeluar grupin punues teknik për vlerësimin e të gjitha aseteve që janë në pronësi të ndërmarrjes shoqërore "Trepça", por ende asnjë takim i këtij grupi nuk është mbajtur. Pas vendimit të Qeverisë për themelimin e grupit punues, ishte potencuar se më së largu pas tre muajve do të duhet të jetë i gatshëm propozimi final për vlerësimin

e të gjitha aseteve që janë në pronësi të ndërmarrjes shoqërore "Trepça" për Qeverinë.

Po më 13 korrik ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, së bashku me Shyqyri Sadikun, kryetar i Sindikatës së Minatorëve të "Trepçë"-s dhe i Këshillit Grevist, patën nënshkruar një marrëveshje gjashtëpikëshe përmes së cilës nisej trajtimi i të gjitha kërkesave të minatorëve. Me anë të kësaj marrëveshjeje sindikata dhe ministri Lluka ishin pajtuar të ndërpritej greva e mina-

Komuna e Gjilanit mbështet Parlamentin Studentor

GJILAN, 9 SHTATOR (ER) - Komuna e Gjilanit dhe Parlamenti Studentor i Universitetit "Kadri Zeka" në këtë qytet kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila parasheh mbështetjen nga ana e kësaj komune në disa fusha, si në bursa, përfaqësim të Parlamentit Studentor brenda e jashtë vendit.

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se kjo komunë me kapacitetet që ka do të jetë gjithmonë mbështetëse e studentëve në programe të ndryshme që janë në favor të studentëve. "Marrëveshja me Parlamentin Studentor është në kuadër të përkrahjes për

projekte studimore të Parlamentit Studentor, mbështetje për programe të bursave dhe përfaqësimit në nivele të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Rasti konkret ku Komuna e Gjilanit përkrahë me këtë marrëveshje dy përfaqësues të Parlamentit për pjesëmarrjen në Samitin e paqes për rini në Seul të Koresë", ka thënë Haziri.

Ndërsa Adrian Bajrami, kryetar i Parlamentit Studentor në Universitetin "Kadri Zeka", ka shprehur falënderimin e tij për mbështetjen që kryetari Haziri ua ka dhënë studentëve nëpërmjet kësaj marrëveshje të bashkëpunimit.



Filloi ndërtimi i rrugës transit në Malishevë

MALISHEVË, 9 SHTATOR (ER) - Ka filluar ndërtimi i rrugës transit për qytetin e Malishevës, e cila është një rrugë unazore e gjatë rreth 14 kilometra dhe do të kushtojë 4.5 milionë euro. Ndërtimi i kësaj rruge me rëndësi të madhe për Malishevën është mundësuar nga Ministria e Infrastrukturës. Shiritin e fillimit të punimeve e kanë prerë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ministri i Infrastrukturës, Pal

Lekaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoti dhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha. Në ceremoninë e fillimit të ndërtimit të kësaj rruge, krahas zyrtarëve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe udhëheqjes komunale të Malishevës, kanë marrë pjesë edhe zyrtarë qeveritarë dhe qytetarë të shumtë. Para fillimit të punimeve në Malishevë kanë qëndruar edhe zëvendëskryeministri, Fatmir

Limaj dhe ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, të cilët janë pritur nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Me këtë të fundit Limaj dhe Lekaj kanë biseduar lidhur me ndërtimin e rrugës së transittit për Malishevën dhe për çështje të tjera që lidhen me infrastrukturën në përgjithësi në Malishevë.

Zëvendëskryeministri Limaj ka pohuar se ky projekt është lajm i madh për Malishevën.



Muharremaj angazhohet për përmirësimin e infrastrukturës për bujqit

THERANDË, 9 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka marrë pjesë në ceremoninë e nisjes së punimeve të rrugës Peqan - Reshtan, e cila do të jetë në dispozicion të zhvillimit të bujqësisë së kësaj ane. "Rruga Peqan-Reshtan (Rruga e gjatë) mbi tri kilometra po hapet për

zhvillimin e bujqësisë. Hapja e rrugëve fushore nënkupton perspektivën për bujqit që duan t'i rrisin kapacitetet e prodhimit. Angazhimi ynë vazhdon", ka deklaruar ai.

Në kuadër të inspektimeve të punimeve në infrastrukturë, Muharremaj ka vizituar fshatin Sopi, ku është duke u ndërtuar

ura e këtij fshati. "Në fshatin Sopi, përveç vizitës së punimeve tek ura, me banorët e shijam kafën e mëngjesit dhe diskutuam edhe për projektet e ardhshme. Qytetari është sovran dhe institucionet janë të obliguara t'i zbatojnë kërkesat që vijnë për mirëqenien sociale të tyre", ka thënë Muharremaj.

Pastrohet shtrati i lumit 'Klina' në Skenderaj

SKENDERAJ, 9 SHTATOR (ER) - Komuna e Skenderajt, në kuadër të aktiviteteve të veta dhe synimeve për një ambient sa më të pastër, ka angazhuar kompaninë e kontraktuar për mirëmbajtje të parqeve dhe hapësirave të tjera publike për ta pastruar shtratin e Lumit "Klina", në një aksion që ka filluar ditë

më parë dhe që do të vazhdojë edhe në ditët në vijim. Sipas zyrtarëve të Komunës së Skenderajt, aksioni i pastrimit të lumit ka vazhduar edhe gjatë fundjavës. Ata kanë theksuar se tashmë është arritur të pastrohet shtrati i lumit me anë të ekskavatorit në gjatësi të madhe.



Kush do ta bëjë vettingun në Shqipëri, Rama dhe Basha?

Bedri ISLAMI

Pikërisht atë ditë që politikani Basha shpalli me bujë se do ta ndërmarrë nismën për një Vetting të politikës, media të ndryshme nxorën edhe pamje të së dashurës së birit të ish-shefit të qeverisë që, në një copë parajse greke, Mykonos, bënte pushimet e saj, e ftuar si "ambasadore" e një firme shampanje të njohur.

Sikur asgjë tjetër të mos ishte e dukshme për hipokrizinë e një klase politike që e bëjnë atë një lloj burse financuese, do të kishte mjaftuar kjo "përballje" mes shefit de jure të opozitës dhe familjes de fakto të saj, për të pasur në mendje se çfarë kanë parasysh këta pinjollë të së keqes dhe se çfarë synojnë të bëjnë.

Vettingu i politikës është thënë tash sa e sa vite nga njerëzit e zakonshëm. Të paktën tash 10 vjet njerëzit e kërkojnë atë dhe kur nuk e gjejnë, nuk kanë çfarë të bëjnë tjetër, veçse t'i ndërrojnë qeveritë, gjithnjë me shpresën se këta që po vijnë do t'ua nxjerrin ujët e zi pasurimit hajdutshe të atyre që ikën.

Nuk e bëri këtë as Berisha kur erdhi në pushtet në vitin 2005, bile disa i mbajti aq afër sa që edhe sot përmalohen për kohën kur ishin bashkë në shtratin e pushtetit. Berisha shkoi edhe më tej: ai, duke u bërë mbrojtës i harbimit politik e financiar të familjes së tij, mblodhi rreth vetes një grusht parazitësh të deriatëhershëm dhe ndërtoi një piramidë politike rrëngjellëse, e cila, sa më shumë ngrinte majën e saj, aq më tej fundoste ata që e kishin ngritur. Përtallja e shpresave shkoi edhe më tej, në një cinizëm të hapur, kur ai, i pari i qeverisë, pa asnjë drithërimë e as ndjenjë përgjegjësie fajtonte njerëzit që e kishin besuar në ligjëratën e tij kundër Nanos, pasi "kishin qenë akuza në kohë fushate".

Edhe Rama erdhi në pushtet, pikërisht nga e njëjta gjë: besimi se do t'ua nxirrte ujët e zi një grupimi qeveritar, i cili, pasi vodhi, hodhi në erë, vrau dhe mashtrroi, kërkoi të bënte dhe e bëri, në fakt, aktin e fundit të atdeshitjes, marrëveshjen e detit me shtetin grek.

Edhe Rama nuk e mbajti fjalën e tij. Njeriu që pritej të ishte frymëzuesi i një tjerre të politikës fatkeqe, në fakt, gjithnjë e më shumë, po bëhet tjerresë i një tragjedie të re: humbjen e besimit dhe bjerrjen e së ardhmes. Për disa pak vite, gjithçka ishte

mishëruar në ardhjen në pushtet të Ramës, mjerisht, në një shumicë të ndjeshme, është shndërruar në një gërmadhë besimi dhe, nëse do të vazhdojë kështu edhe në tre vjetet pasues, gjithçka do të jetë tepër e mjerueshme. Si duket, edhe sot e kësaj dite klasa politike, në fakt paraklasa politike, përcaktim i Moikom Zeqos, është të paktën dhjetë vjet më pas sesa njerëzit e zakonshëm.

Për çfarë e kërkon Basha vettingun e politikës? Përse shefi i qeverisë, Edi Rama, i tha aq me ngut "posi, hajde, e bëjmë dhe e fillojmë nga vetja".

A nuk ka pasur deri tani ky shtet, kjo qeveri, këto institucione, mekanizma kontrolli mbi klasën politike, mbi ministrat, zëvendësit, drejtorët, shefat e policisë, gjykatësit, prokurorët, presidentët, shefat e qeverisë dhe të opozitës?

Strukturat kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të mjaftueshme, por e vërteta është se këto ligje dhe dispozita ligjore janë bërë si llastikët e dikurshëm të çorapeve të grave, mund t'i tërheqësh sa të duash dhe si të duash. Ajo që po ndodh me sistemin e drejtësisë, ku gjysma e arkës janë fruta të prishura dhe gjysma tjetër e ka në vete një pjesë të prishur, por të pazbuluar, tregon se e keqja ka ardhur nga sipër, si ai peshku që qelbet nga koka.

"E ndershme është, thanë për një vajzë në pragun e fejesës, veçse pak shtatzënë". I mirë edhe propozimi i Bashës dhe amendamentet që ka nisur në parlament, veçse hesapet tregojnë se pazari u bë pa hanxhiun. Njerëzit e zakonshëm kërkojnë shkundje të fuqishme të botës së politikës. Në të gjitha anët. Nga të gjitha drejtimet. Për të gjitha kohët. Nga akti i parë i shkatërrimit e deri te vjedhjet masive. Nga vrasja e parë, më herët se ajo e 2 prillit në Shkodër, deri te tentimi për një puç parlamentar në dhjetorin e vitit të shkuar. Që nga vjedhjet masive në Rrugën e Kombit e deri te koncesionet e sotme. Që nga lejet politike për të burgosur, të cilësuar "të fortë" në pragun e zgjedhjeve të vitit 2009, dhe në shumicën e tyre këto ishin vrasës, e deri tek urdhri për të vrarë më 21 janar. Që nga orët e shtrenjta në duart e tyre, floririn e grave dhe salltanetet e burrave dhe deri tek vilat në Gjirin e Lalzit. Aq sa ka kushtuar një udhëtim i Zenit të berishajve është paga vjetore e një halle-madhi. Aq sa kanë kushtuar studimet jashtë shtetit të



Nishan-llive janë pagat e tre vjetëve të një punëtori. Të kërkosh vetting për pasurinë, ndërsa bijtë e bijat e politikës zbavitën nëpër resorse luksoze është pak të thuash se po tallen me fukarenjtë. Është e vështirë të gesh një dorë me njerëz të politikës fëmijët e të cilëve janë diplomuar apo studiuar në këtë vend, megjithëse prej atje mund të kenë ardhur edhe shumë të përgatitur, por edhe karabushë të klasës së parë parlamentare. Vettingun, njerëzit e zakonshëm, nuk e perceptojnë dot si një luftë klanesh brenda politikës, si e ka shtruar Basha dhe si e shtron edhe sot e kësaj dite, ku, me gjithë korrigjimet që kishte harruar "pa dashje" për kontrollin pasuror, përsëri të kujton dëshirën e fshehur për krijimin e një strukture paralele, e cila, duke larë duart, shpëton edhe mëkatet.

Kush do ta bëjë këtë vetting?

Rama dhe Basha? Ata kanë sjellë një dëshmi që për hatër të pushtetit mund të bëjnë rokada të forta politike, si në zgjedhjet e shkuara të qershorit 2017. Mund ta ndajnë tepsinë në dy pjesë dhe të mos lënë të afrohet kursesi një i tretë, ndërsa pjesa e popullit mbetet si ato kojet anësore të byrekëve.

Basha dhe Rama nuk bëjnë dot vetting në politikë, pasi janë objekt i hetimit. Ndoshta objekti i parë i hetimit.

Do ta bëjnë gjykatësit? Cilët? Për të gjetur një të saktë mes tyre duhet t'i biesh rreth e qark gjithë korpusit të drejtësisë: Nëse, deri në vitin 2013, drejtësia ishte shtroja e poshtme e pëdëistëve, a nuk mund të jenë sot mbulesa e rilindësve?

Shpejtimi i Bashës, bashkëngjitur edhe Ramës që, në fakt, nuk kishte se si ia bënte ndryshe, për ta krijuar vettingun e tyre, kur edhe pak kohë ka mbetur për t'u ngritur strukturat ndërkom-bëtare të rëndësishme në luftën e tyre kundër krimit, më shumë se gjithçka tjetër duket se u thotë atyre, "Sikter, ne jemi vetë këtu" dhe, pastaj, njëra dorë do të lajë tjetrën dhe të dyja do të dalin me faqe të zbardhur. Kush do ta kontrollojë këtë vetting politik për krimin e skajshëm dhe për harbimin e pasurisë?

Komisionet parlamentare?

Si ai i Tahirit që nuk u mblodh asnjëherë dhe vetëm kur i erdhi veza për të dalë, kërkuan kohë të kakarisin edhe një herë. Ka ndonjë njeri në këtë vend që beson te një komision parlamentar që, edhe kur mblidhet për vrasjet e 21 janarit, fajëson të vrarët se ishin me duar në xhepa? Një Parlament që nuk ka forcë as të mbledhë një komision parlamentar të dorës së parë, si ai i ligjit për zgjedhjet, kusht i domosdoshëm për integrimin, si mund të ngrehë sinqerisht e seriozisht një kontroll mbi veten.

Më shumë sesa punë serioze, i ngjan asaj fjalës së vjetër "më ka çue nana, me la gojën".

Një vetting i bërë kështu, shpejt e shpejt, jashtë pranisë ndërkom-bëtare dhe jashtë monitorimit të tyre, është një hiç. Një asgjë. Një përtallje e re mbi pritshmëritë. Një alibi, që mund të bëhet e për-bashkët dhe që mund të sjellë jo pak mëri dhe zemërim. Vettingu në politikë është një domosdoshmëri. Për fat të keq, ne kemi një klasë parapolitike e cila nuk mënon të vjedhë, të pasurohet marramendshëm, të harbohet

familjarisht dhe këtë ta quajnë si një virtyt.

Atëherë kush do të jetë objekt i këtij vettingu?

Vetëm qeveria e sotme, duke bërë një amnisti për të djeshmen?

Ligi i ri për drejtësinë përjashtoi nga kontrolli të gjithë ata gjyqtarë e prokurorë që do të largoheshin vetiu nga sistemi. Do të ishin jashtë vettingut.

Po ata, që për mëri të një shefi partie, nuk janë më deputetë, shefa, ministra, shefa partie etj., çfarë do të bëhet? Do të jenë ata në qetësinë e tyre, sepse nuk janë më në politikë.

Një nga deputetët vrapoi të brohorasë se "unë jam sot me Lulin", por me cilin Lul, atë që fshihet pas vrasjeve të 21 janarit dhe është ende një njeri-pjesë e botës së krimit, apo me Lulin që duke dashur të fshehtë një të vërtetë të njohur, mund ta sigurojë mbylljen e syve.

Muaj e vite u deshën të përgatiten të gjithë strukturat, ligjet dhe në fund miratimi i detyrueshëm i sistemit të drejtësisë.

Mos do t'i ngajë kjo sfidë e nëndheshme asaj marrëveshje kushtetuese mes Berishës dhe Ramës për ndryshimet kushtetuese, ku shefi i partisë u bë zot e shkop dhe ku dinjiteti i shtetit u mor nëpër këmbë si një top rreckash?

Vettingu i politikës është i domosdoshëm. Por ai duhet bërë i thelluar, deri në rrënjë, duke e hequr të keqen dhe duke ndjellë seriozisht si një dobi për vendin, mendësinë e ndëshkimit ndaj së keqes, pavarësisht se nga cili ka ardhur dhe se kush e ka mbështetur.

Atëherë do të kemi një ligj të saktë, ndaj të cilit nuk do të zgërdhijet askush duke bërë pushime shampanjeze dhe duke u pasuruar pa punuar askund.

Koreja e Veriut shënon 70-vjetorin, pa raketa balistike

PHENIAN, 9 SHTATOR - Koreja e Veriut ka shënuar 70-vjetorin e krijimit të shtetit përmes një parade të madhe ushtarake. Por, në këtë paradë nuk janë ekspozuar raketat balistike interkontinentale, që janë bërë subjekt i sanksioneve ndërkombëtare. Lideri verikorean, Kim Jong Un, ka shikuar teksa trupat,

artileria dhe tanket kanë parakaluar në qendër të kryeqytetit Phenjan, kanë raportuar agjencitë e lajmeve. Kimi nuk ka mbajtur fjalim para masës, ku ishin të pranishëm edhe delegacionet e larta nga shtetet që janë miqësore me Korenë Veriore, përfshirë këtu Kinën dhe Rusinë.

Ka pasur spekulime se presidenti i Kinës, Xi Jinping, do të merrte pjesë në shënimin e 70-vjetorit të krijimit të Koresë së Veriut, por Pekini zyrtar ka dërguar atje kreun e Parlamentit. Po ashtu, Rusia ka dërguar kryetaren e Dhomës së Lartë të Parlamentit, Valentina Matviyenko.



Zgjedhjet parlamentare në Suedi, pritet fitore e djathtistëve

Të dielën 7,3 milionë suedezë kanë votuar për deputetët e ri të vendit. Sipas sondazheve, partia ekstremiste e djathtë, "Demokratët Suedezë", ndodhet para një suksesi të madh, kurse partitë tradicionale para një dileme

STOKHOLM, 9 SHTATOR - Për një kohë të gjatë, Suedia konsiderohej shtet model për çështjet sociale dhe miqësor ndaj të huajve. Por, pasi në tre vjetët e fundit në vend erdhën 300 000 emigrantë, për banor ky vend ka më shumë të huaj sesa çdo vend tjetër, gjendja ndryshoi. Nga kjo përfituan "Demokratët Suedezë", SD, një parti ekstremiste e djathtë dhe armiqësore ndaj të huajve.

Vlerat e saj u rritën shumë, deri në 20 %, madje disa vëzhgues mendojnë se kjo parti mund të marrë një të tretën e votave. Parlamenti i ri suedez me 349 votat e tij pritet të ndodhet para bisedimeve të vështira dhe të gjata për krijimin e qeverisë së re. Me gjasë, socialdemokratët qeverisës rreth kryeministrit, Stefan Löfven mund të mbledhin më shumë vota, por sondazhet



parashikojnë rënien në 25 %, krahasuar me 31 % në mandatin e kaluar. Kështu ata bashkë me Partinë e Gjelbër nuk pritet të kapin mazhorancën e duhur. Për shkak të hovit të madh të demokratëve suedezë djathtistë, shihet e

pamundur një aleancë e katër partive konservatore dhe liberale. Dy blloqet kryesore politike e kanë përjashtuar mundësinë e një koalicioni me SD, një parti armiqësore edhe ndaj BE-së. Në Suedi është rritur, ashtu si

edhe në Gjermani, një frikë e paqartë, me gjithë rritjen ekonomike dhe papunësinë e ulët, të cilën e shfrytëzojnë ekstremistët e djathtë. Socialdemokratit Löfven nuk arriti t'i bindë zgjedhësit, me gjithë kthesën në politikën e emigracionit, përmes një politike "ligj dhe rregull". Edhe incidentet e muajve të fundit u dhanë dorë "demokratëve suedezë": Në gusht disa të rinj brenda një nate u vunë zjarrin në jugperëndim të vendit 100 automjeteve, edhe konfliktet mes bandave të dhunshme zënë kryetitujt e gazetave. Për çdo krizë si, p. sh., ajo e zjarreve në pyje, përgjegjëse u bë qeveria e Löfven, vlerat e së cilës ranë gjithnjë e më shumë në sondazhe.

Ish-presidenti Obama bën fushatë për kandidatët demokratë



WASHINGTON, 9 SHTATOR - Ish-presidenti amerikan Barack Obama u tha të pranishmëve në një tubim të Partisë Demokratike të shtunën në Kaliforni se Qeveria e Shteteve të Bashkuara "është një qeveri për të gjithë, nuk është në shitje". Ai shtoi se çdo problem mund të zgjidhet duke punuar së bashku, nëse u qëndrojmë besnikë traditave më të mira amerikane. Obama ka mbajtur një profil të ulët publik që nga largimi nga posti i presidentit, por me rastin e zgjedhjeve të mesmandatit që do të mbahen në nëntor, ai foli të

shtunën në një tubim në Anaheim të Kalifornisë në mbështetje të kandidatëve demokratë në rrethe të fituara nga kandidatja presidenciale demokrate Hillary Clinton në vitin 2016. "Ky është një moment i rëndësishëm në historinë tonë dhe fakti është se nëse nuk avancojmë, gjërat mund të keqësohen. Kur ka mungesa në demokracinë tonë, kur ne nuk marrim pjesë, kur ne nuk mbajmë vëmendje se çfarë ndodh, zëra të tjerë e mbushin hapësirën. Por lajmi i mirë është se pas dy muajsh ne

kemi mundësinë për të risjellë pak normalitet në politikë", tha ai. Ish-presidenti u bëri thirrje mbështetësve të tij që të jenë më aktivë. "Kërcënimimi më i madh për demokracinë tonë, siç thashë dje, nuk është një individ, nuk është një miliarder i madh, është apatia, është indiferenca. Kërcënim është kur nuk bëjmë atë që ne duhet të bëjmë", tha ai. Obama tha se nuk ka probleme që nuk mund të zgjidhen nëse "ne punojmë së bashku dhe u qëndrojmë besnikë traditave më të mira amerikane".

Protesta në Rusi kundër ngritjes së moshës së pensionit

MOSKË, 9 SHTATOR - Përkrahësit e udhëheqësit të opozitës, Alexei Navalny, kanë mbajtur protesta në gjithë Rusinë lidhur me planet për ta rritur moshën e pensionit në vend, ndërsa rusët votojnë në zgjedhjet rajonale. Navalny ishte parashikuar të dilte në një demonstratë në

Moskë të dielën, por muajin e kaluar u dënua me 30 ditë burg për shkelje të ligjeve për protestat. Ai tha se ndalimi kishte si objektiv t'i frenonte planet e tij për tubime në gjithë vendin kundër ngritjes së moshës se kur punonjësit mund të fillojnë të marrin pensione.

Por përkrahësit e Navalny vazhduan me planet për protestat. Demonstratat janë mbajtur pa miratimin e Qeverisë. Organizata OVD-Info që vëzhgon shtypjen politike, njoftoi se 153 protestues janë arrestuar në gjithë vendin, me tubime në rreth 80 qytete.





ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




E rrallë

Kinë, gjendet fosili i një dinozauri

Agjencia e lajmeve "Xinhua" ka njoftuar se shkencëtarët e këtij vendi, në Lijialong të provincës Hebei, hasën në fosil të kockave të legenit të

dinozaurëve që ka jetuar para 130 milionë vjetësh. Hulumtimet e zhvilluara në fosilin e copëtuar tre-



gojnë se dinozauri ka qenë me madhësi prej 7 deri në 10 metra.

BARSOLETA E DITËS



Pacientja: Doktor, a me hiqet ndonjëherë reuma?
Doktori: Po.
Pacientja: Kur?
Doktori: Kaq vjet sa ke sot pas vdekjes.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Në pamje ajrore nga një helikopter shihet anija e cila u përplas në një beton për shkak të erërave të forta në qytetin Nishinomiya. /AFP/


Në ora 18:20

"FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E jashtëzakonshme

Në Kroaci gjendet thesari nënujor me vlerë qindra milionë euro

Një grup zhytësish kroatë gjetën në një anije të zhytur që përmban thesar me vlerë dhjetëra miliona euro, shkruan "Ansa". Anija i përket mbretit të Italisë, e zhytur në Adriatik në



vitin 1866, në betejën e famshme detare të Lisë (Vis në kroatisht). Ky lajm është transmetuar nga mediat kroate, të cilat citojnë gjuetarin e thesareve nënujore, Lorenzo Marović nga Liza.

 <p>DASHI Nuk keni mundur t'u jepni përgjigje dyshimeve të shumë personave sot. Nëse e lini të kalojë këtë situatë, gjërat do të mbeten pa sqaruar.</p>	 <p>DEMI Sot jeni në fushë të hapur me kundërshtarët tuaj. Duhet të keni kujdes nga ata që ende nuk janë shfaqur përballë jush.</p>	 <p>BINJAKËT Do ta keni të vështirë t'i keni nën vëzhgim personat me të cilët keni marrëdhënie pune. Shumë prej tyre janë të prirë të neglizhojnë.</p>	 <p>GAFORRJA Nuk mund të gënjeni sot ata persona që rrinë pranë jush. Edhe pse po tentoni t'i fshihni ndjenjat tuaja, dikush do të zbulojë çfarë ju shqetëson.</p>	 <p>LUANI Edhe pse nuk po e pranoni, keni nevojë të keni pranë vetes një person të caktuar që dashur pa dashur ju ndryshon humorin dhe jua kthen buzëqeshjen.</p>	 <p>VIRGJËRSHA Mungesa e besimit ju ka bërë me të ftohtë në marrëdhënie me të tjerët. Jo më të gjithë mund të mbani të njëjtin qëndrim indiferent.</p>
 <p>PESHORJA Tregohuni më të hapur me të tjerët dhe ata do të bëjnë çmos t'ju tregojnë mirënjohje. Zgjidhni personat që besoni në rrugën tuaj.</p>	 <p>AKREPI Duhet ta vini veten në vend të dikujt tjetër që të mund të gjykoni një situatë të caktuar. Jo gjithmonë gjërat janë ashtu siç duken.</p>	 <p>SHIGJETARI Problemet tuaja zgjidhni përpara se të jetë shumë vonë. Dikush do të luajë një lojë të pistë nga e cila do të dilni jo pak të lënduar.</p>	 <p>BRICJAPI Ta konkretizoni atë që keni në mendje sot nuk do të jetë shumë e vështirë. Mjafton të flisni me njerëzit e duhur dhe gjërat do të realizohen.</p>	 <p>UJORI Sot mos kaloni direkt në sulm kur t'ju pyesin për gjëra shumë të thjeshta. Nervozizmi juaj do të lerë të kuptohet që ka diçka që nuk shkon.</p>	 <p>PESHQIT Do t'ju lindin disa probleme në fushën profesionale sot që do të duhet me doemos t'i zgjidhni. Jeni në udhëkryq dhe po tentoni ta gjeni drejtimin.</p>

Martohet Janel Parrish



Artistja 29-vjeçare dhe i dashuri i saj Chris Long u kurorëzuan të shtunën në Hawaii. "Jemi shumë me fat që e gjetëm njëri-tjetrin në këtë botë të çmendur", ka thënë Janel për "Us

Weekly". "Duke u martuar me burrin e ëndrrave të mia, e rrethuar nga familjarët dhe miqtë. Kjo është ëndërr", ka thënë ajo. Chris dhe Janel u fejuan gjatë muajit tetor në vitin 2017.

Përleshjen fizikisht Nicki Minaj dhe Cardi B në Nju Jork



Këngëtarët Nicki Minaj dhe Cardi B janë përleshur në një ndejë të organizuar në kuadër të Javës së Modës në Nju Jork. Yjet e njohura të muzikës besohet se kanë vënë në shprehje rivalitetet ndërmjet tyre duke eskaluar në dhunë fizike. Pavarësisht prej pranisë së shumë gazetarëve dhe

personaliteteve të njohura, as Minaj e as Cardi nuk e kanë pasur problem të shkëmbejnë ofendime ndaj njëra-tjetrës dhe më pas të përleshjen edhe fizikisht. Për shkak të përleshjes fizike ndërmjet dy këngëtareve, është dashur intervenimi i sigurimit për të qetësuar gjithçka.



Rita Ora bëhet me shtëpi të re në Prishtinë

Këngëtarja me prejardhje shqiptare me famë botërore, Rita Ora, është bërë me shtëpi të re në Prishtinë. Lajmin e ka bërë me dije babai i saj, Besnik Sahatçiu Ora, i cili ka

postuar fotografi në "Facebook", me përshkrimin: "Të lumtur për shtëpinë tonë të re në Prishtinë". Imazhet që babai i artistes postoi janë familjare, ku shihen motra dhe vëllai i Ritës dhe mamaja.

Mac Miller po punonte për këngë të reja pak orë para vdekjes

Mac Miller lëshoi një këngë përfundimtare para se të vdiste. Reperi 26-vjeçar ishte duke punuar në një projekt të ri vetëm pak orë para vdekjes së tij dhe këtë e ndau me ndjekësit në "Instagram". Në katër video, të cilat ende janë në profilin e tij, Mac lëshon këngën në një gramafon. Mac Miller u gjet i vdekur të shtunën në shtëpinë e tij pasi dyshohej për një mbidozë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SCOTLAND - ALBANIA

1

PORTUGAL - ITALY

1

MONTENEGRO - LITHUANIA

1

Kosova dëshiron vetëm fitore në 'Fadil Vokrri'

Kosova sonte e zhvillon ndeshjen e parë në stadiumin "Fadil Vokrri" dhe po të parën në shtëpi në kuadër të Ligës së Kombeve, prandaj "Dardanët" në përballjen me Ishujt Faroe dëshirojnë t'i marrin tri pikë. "Jemi ekipi më i mirë në grup dhe duhet t'i fitojmë të gjitha ndeshjet. Ndaj Ishujve Faroe luajmë vetëm për fitore. Do të përpiqemi të paraqitemi mirë jo vetëm të hënën, por edhe në ndeshjet e tjera", ka thënë Bernard Challandes

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka opsion vetëm fitoren në ndeshjen kundër Ishujve Faroe në kuadër të Ligës së Kombeve. Kjo ndeshje do të zhvillohet sonte (e hënë) në stadiumin "Fadil Vokrri" me fillim nga ora 20:45, kurse përfaqësuesja pritet të ketë përkrahje jashtëzakonisht të madhe për faktin se luan në Prishtinë pas një kohë të gjatë dhe ndeshja ka rëndësinë e madhe, sepse mund ta dërgojë Kosovën drejt kualifikimit në Kampionatin Evropian. Trajneri i "Dardanëve", Bernard Challandes, ka thënë se Kosova e ka ekipin më të mirë në grupin e saj dhe se duhet t'i fitojë të gjitha ndeshjet. "Jemi ekipi më i mirë në grup dhe duhet t'i fitojmë të gjitha ndeshjet. Ndaj Ishujve Faroe luajmë vetëm për fitore. Do të përpiqemi të paraqitemi mirë jo vetëm të hënën, por edhe në ndeshjet e tjera", ka thënë Bernard Challandes, duke bërë me dije se do

të këtë ndryshime edhe në formacion. "Do të ketë ndryshime në formacion krahasuar me ndeshjen ndaj Azerbajxhanit. Besar Halimi është i gatshëm për të luajtur, por nuk e konfirmoi pjesëmarrjen në formacion një ditë më parë. Presim ndeshje tjetër për dallim me atë ndaj Azerbajxhanit. Presim lojë me pasime të shpejta dhe sulme", ka shtuar ai. Trajneri zviceran në konferencën për medie ka konfirmuar se mbrojtësi Kastriot Dërmaku është larguar nga përfaqësuesja për arsye personale.

Ndërkaq kapiteni Samir Ujkani ka ripërsëritur edhe një herë se Kosova kërkon fitore për ta nderuar legjendën e futbollit shqiptar, Fadil Vokrri. "Do të luajmë për ta nderuar emrin e legjendës, Fadil Vokrri. Atmosfera është e mirë dhe lojtarët janë të gatshëm për ta dhënë maksimumin", ka thënë ai.

Për ndeshjen ndaj Kosovës ka folur edhe trajneri i Ishujve Faroe, Lars Olsen, i cili ka thënë se nuk do të jetë ndeshje e lehtë, pasi Kosova ka ekip të

mirë dhe do ta ketë përkrahjen e madhe të publikut. "Vijmë këtu pas një fitoreje kundër Maltës, e cila shfaqti lojë të mirë. Kosova ka ekip të mirë. Ajo ka mbetur baras me Azerbajxhanin. Nuk do të jetë e lehtë, pasi kundërshtari do të luajë para publikut të vet e, sa kam dëgjuar, në stadium do të jenë 12 mijë deri në 13 mijë adhurues. Këtë mbështetje do ta ndiejnë edhe futbollistët në fushë", ka thënë Olsen, duke shtuar: "Ne jemi takuar në Frankfurt me Kosovën, ku humbëm 2-0, por ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk e di a janë ende ata lojtarë pjesë e saj, pasi nuk kam njohuri për përbërjen. Ndonëse në grupin tonë Kosova është favorite në letër, unë mendoj se kemi grup shumë të baraspeshuar dhe nuk ka favoritë absolutë. Ne kemi pritur gjatë për këtë dhe do të orvatemi të bëjmë më të mirën dhe ndeshjet në shtëpi janë mjaft të rëndësishme". Përfaqësuesja e Kosovës bën pjesë në Ligën D, Grupin 3. Të premten në Baku ajo mori një pikë nga ndeshja kundër Azerbajxhanit.

SHKURT

Gjetan Keta, kampion bote në WBU

Gjetan Keta është kampioni i ri i botës për peshat e mesme në kategorinë WBU. Në duelin e zhvilluar në Dibër të Madhe, boksieri shqiptar mundi boshnjakun Sladan Janjanin. Ishte një ndeshje ku Gjeta ishte gjithë kohës superior ndaj rivalit. Agresiviteti i tij u vu re që në raundet e para të sfidës duke bërë që Janjanin të mos i rezistojë shumë Gjetës duke u tërhequr në raundin e pestë të sfidës, ndërkohë që në raundet e mëparshme ai ra dy herë në "knock-down". Për Gjetën, që u ngjiti në ring pas një shkëputjeje disamujore, kjo ishte fitorja e 23-të në karrierë.

Zenelaj i bashkohet KB Ponte Prizreni

Qendra e njohur Urim Zenelaj e ka përforcuar KB Ponte Prizreni. Ky klub e ka vlerësuar Zenelajn si transferimin më të madh për sezonin ri. "Me këtë fond të lojtarëve besojmë se do ta përfaqësojmë në mënyrë sa më dinjitoze basketbollin prizrenas. Urimi stinorin e kaluar ishte pjesë e KB Bashkimi, ndërsa momentalisht është edhe në listën e Përfaqësueses së Kosovës në basketboll", thuhet në njoftimin e Ponte Prizreni.

Ragip Xhaka: Taulanti ma ka bërë zemrën sa malet e Shqipërisë

Babai i Taulant Xhakës, Ragipi, ka thënë se djali i tij, me golin e shënuar ndaj Izraelit, ia ka bërë zemrën sa malet e Shqipërisë. "Ndeshja ishte super. Kam kënaqësi pasi djemtë kanë luftuar në çdo milimetër dhe sukcesi nuk mungoi. Nuk e përshkruaj dot gëzimin kur Taulanti shënoi. Ai u rikthye pas 12 javësh. Ma ka bërë zemrën sa malet e Shqipërisë. Do ta shoh Kosovën e më pas do të shkoj në Skoci. Nuk e kam ndarë kurrë Shqipërinë, pasi e kam pasur zemrën këtu", ka thënë Ragip Xhaka.

Ramosi: Modriqi e meriton 'Topin e Artë'

Kapiteni i Spanjës, Sergio Ramos, ka shprehur mendimin se mesfushori i Real Madridit, Luka Modriq, "është nga lojtarët e paktë që, nëse do ta fitonte çmimin e 'Topit të Artë', do të gëzoheshin sikur ta kisha fituar vetë. Shpeshherë e marrin ata që kanë më shumë marketing", ka thënë Ramosi.

Kuqezinjtë për fitore në Skoci

TIRANË, 9 SHTATOR - Kombëtarja e Shqipërisë, pas fitores kundër Izraelit, sonte (e hënë) do ta luajë ndeshjen e dytë në Ligën e Kombeve kundër Skocisë në "Hampden Park". Synim i kuqezinjve që drejtohen nga

trajneri Christian Panucci është fitorja, kurse një synim të njëjtë e kanë edhe skocezët. Trajneri i vendësve, Alex McLeish, ka marrë vetëm një fitore në pesë ndeshje (1 fitore, 4 humbje). Ai e ka parë skuadrën e vet të

shënojë vetëm 1 gol në 450 minuta lojë. Për më tepër, humbja 4-0 e pësuar në miqësoren e luajtur kundër Belgjikës tri ditë më parë ka regjistruar edhe ecurinë e tyre më të keqe prej tri humbjesh radhazi të pësuar

në shtëpi. Shqipëria, nga ana tjetër, ka pasur një ecuri të ngjashme: 1 fitore, 5 humbje, para takimit të fituar kundër Izraelit. Gjithashtu, kuqezinjtë kanë pësuar gol në shtatë nga tetë ndeshjet e fundit.



Salahi për Egjiptin, shënoi dy gola, dhuroi dy asistime dhe humbi dy penallti

Cairo, 9 shtator - Ylli i Liverpoolit pati paraqitje të përzier pas kthimit në formacionin e Egjiptit. Salah shënoi dy herë dhe dhuroi dy asistime në fitoren prej 6 me 0 që Egjipti e realizoi përballë Nigerisë. Në minutën e 10 për Egjiptin u akordua penallti

dhe goditjen e Salahit e priti portieri i Nigerisë. Vetëm dy minuta më vonë sulmuesi asistoi për bashkëkombësin e tij Marwan Mohsen, ndërsa epërsinë në 2 me 0 e ngriti lojtari tjetër i Egjiptit, Ayman Ashraf. Sulmuesi i Liverpoolit u gjend prapë në pikën e

penalltisë pas gjysmë ore lojë, por goditja e tij u prit prapë nga portieri i Nigerisë, ndërkaq pas kthimit të topit përsëri te egjiptiani, ai realizoi për 3 me 0. 26-vjeçari u bë protagonist edhe i golit të katërt të Egjiptit, por kësaj here duke asistuar për

autorin e golit të parë, Marwan Mohsen, në minutën e 73-të. I nominuar për "Topin e Artë" realizoi edhe për rezultatit 5 me 0 të kombëtares së tij, katër minuta para fundit, kurse rezultatit final prej 6 me 0 e vendosi Mohamed Elneny në minutat



shtesë të ndeshjes.

Drenasi, i pakalueshëm për Vëllaznimin



LIGA E PARË

Onix-Dukagjini	2-2
Vitia-Istogu	3-0
Ramiz Sadiku Fushë Kosova	2-0
Vëllaznimi-Drenasi	0-0
Arbëria-2 Korriku	2-1
Kika-Vushtrria	0-3
Vllaznia-Bashkimi (K)	0-3
Trepça-Besa	0-1


TABELA

		PIKË
1.Besa	3	7
2.Vëllaznimi	3	7
3.Onix	3	7
4.Dukagjini	3	7
5.Vushtrria	3	6
6.Arbëria	3	6
7.Vitia	3	6
8.Bashkimi (K)	3	4
9.Drenasi	3	4
10.Kika	3	4
11.Ramiz Sadiku	3	3
12.Fushë Kosova	3	3
13.Istogu	3	3
14.Vllaznia	3	1
15.Trepça	3	0
16.2 Korriku	3	0

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Skuadra e Drenasit në Ligën e Parë ka arritur të shkaktojë befasi në kuadër të javës së tretë, pasi ka luajtur baras ndaj Vëllaznimit në Gjakovë (0-0). Vendësit e kishin dominimin, por nuk arritën ta thyejnë mbrojtjen e skuadrës mysafire. Siç dihet, skuadra gjakovare, së bashku me Besën e

Pejës, janë favoritët kryesorë për t'u inkuadruar në IPKO Superligë. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar të dielën, Besa e mposhti Trepçën (0-1). Skuadra e Vushtrrisë ishte bindëse ndaj Kikës (0-3). Të shtunën derbi i skuadrave nga Rrafshi i Dukagjinit, Onixit dhe Dukagjinit të Klinës, përfundoi 2-2.

Dovizioso triumfon në San Marino



SAN MARINO, 9 SHTATOR - Pas braktisjes së Çmimit të Madh të Britanisë dy javë më parë, Moto GP është kthyer me Çmimin e Madh të San Marinos për atë që duhet të kishte qenë gara e 13-ë por që, në fakt, është e 12-a. Andrea Dovizioso ka fituar një garë që duhej të ishte dominuar nga Ducati, me Jorge Lorenzon që

ka qenë në vendin e dytë deri në xhiron e parafundit, kur ka gabuar dhe ka dalë nga pista. Rrëzim nga i cili ka përfutur spanjollin i Hondas, Marc Marquez, i cili është ngjitur në vendin e dytë të podiumit, i ndjekur nga Crutchlow. Ka zhgënjyer Valentino Rossi, i cili ka dalë në vendin e shtatë. Yamaha është motori me më shumë fitore në

këtë circuit, që nga koha kur është kthyer të jetë pjesë e kalendarit, me gjashtë fitore kundrejt katër të Hondas. Ducati, para garës së sotme, kishte fituar vetëm një herë këtu, 11 vjet më parë me Stoner. Ndërkohë, piloti më i suksesshëm në këtë pistë është spanjollin Marc Marquez, me pesë fitore të marra në të tre rathët.

SHKURT

Ajeti, pas golit: Ishte ditë e përsosur

Albian Ajeti ka debutuar me gol me fanellën e Zvicrës në ndeshjen kundër Islandës, të cilën zviceranët e fituan me rezultat 6-0. Sulmuesi i Bazelit u inkuadrua në lojë në minutën e 65-të, ndërsa u regjistrua në listën e golashënuesve në minutën e 71-të. "E filluam ndeshjen mirë, bëmë presion dhe i shënuam disa gola. Unë isha në gjendje ta shënoja golin tim të parë (për Zvicrën). Ishte një ditë e përsosur. Ka qenë shumë lehtë të integrohem në këtë skuadër, sepse është e shëndetshme dhe unë veçse i njihja shumë nga lojtarët", ka thënë Ajeti.

Osaka triumfon në US Open

US Open i femrave është mbyllur me një rezultat befalues, me japonezen Naomi Osaka që ka mundur favoriten Serena Williams në finalen e luajtur në New York. 20-vjeçarja, tenistja më e re që merr pjesë në finalen e US Open që nga Wozniacki në 2009-n, ka dominuar në ndeshje, duke fituar titullin në dy sete. Pasi Osaka theu shërbimet e amerikanes në lojën e tretë të setit të parë, ajo nuk e ktheu me kokën mbrrapa dhe e fitoi setin me rezultatit 6-2. Seti i dytë ka qenë më i luftuar, me Williamsin që ka thyer shërbimet e japonezes në lojën e pestë, por e ka humbur avantazhin në lojën e shtatë. Osaka nuk ka bërë të njëjtin gabim dhe e ka mbyllur setin me rezultatit 6-4, duke fituar finalen e saj të parë të madhe.

Kloppi: Gerrardi nuk ka nevojë për këshilla

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se legjenda e Liverpoolit, Steven Gerrard, i cili është trajner i Rangersit, nuk ka nevojë të marrë këshilla nga askush sa i përket pozitës së trajnerit. "Rangers ishte i mrekullueshëm në Evropë. Gerrardi, duke punuar, e ka bërë një skuadër shumë të mirë bashkë. Kur unë fillova karrierën time si trajner, nuk kërkoja ndihmë apo këshilla nga askush sepse nuk e dija se kë duhej ta pyesja. Steveni nuk kërkon ndihmë apo këshilla pasi që ai nuk ka nevojë për to. Ne vazhdimisht bisedojmë me njëri-tjetrin, por jo për t'i dhënë unë këshilla atij", ka thënë Klopp.

Lëndohet rëndë Luke Shaw

Mbrojtësi i majtë i Manchester Unitedit, Luke Shaw, është lënduar rëndë në takimin e sotëm në mes të Anglisë dhe Spanjës. Ai është bartur me barelë jashtë fushës në fillim të pjesës së dytë të ndeshjes, pas një përplasjeje të frikshme me Dani Carvajalin. Shaw mbeti i shtrirë për disa minuta dhe u mjekua nga stafi mjekësor para se të bartej jashtë fushës me barelë. Kujtojmë se Shaw kishte thyer këmbën më parë që e kishte lënë jashtë fushës për një kohë të gjatë.

Këta janë lojtarët që Zidane i dëshiron në United

Trajneri Zinedine Zidane pritet të jetë pasardhësi i Jose Mourinhos te Manchester Unitedi. "The Mirror" raporton se ish-trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, ka filluar ta përgatisë listën me lojtarët që i dëshiron në "Old Trafford". Në këtë listë bëjnë pjesë Toni Kroos (Real Madrid), Thiago Alcantara dhe James Rodriguez (Bayern Munchen) dhe Edison Cavani (PSG).



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit është e ngarkuar për të privatizuar Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë përmes metodës së spin-off-it dhe likuidimit. Investitorët ftohen t'i blejnë përmes tenderit të hapur dhe konkurreues asetet e disa NSH-ve në likuidim të radhitura më poshtë.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT SHPALL SHITJEN E 41-të TË ASETEVË TË NDËRMARRJEVE NË LIKUIDIM

Subjektet / njësitet e përcaktuara më poshtë janë nën juridiksionin e AKP-së në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-034 për Privatizim mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ofertat e mbyllura për njësitet në vijim duhet të dorëzohen në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve më 3 tetor 2018, ndërmjet orës 10:00 dhe 12:00 në Prishtinë (sipas kohës lokale të Evropës Qendrore), dhe të shoqëruara nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, siç është parashikuar për secilin artikull. Të gjitha ofertat duhet të paraqiten në përputhje me Rregullat e Tenderit të zbatueshme për shitjet me likuidim. Të gjitha njësitet e radhitura këtu ofrohen për shitje mbi bazën "siç është" dhe "ku është" dhe do të shiten në përputhje me termet ligjore dhe kushtet e shitjes. Veçanërisht dhe pa ndryshuar kushtet e tilla, AKP nuk jep garanci, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, sa i përket gjendjes apo përshkrimit të njësive që shiten ose përshtatshmërisë së tyre për ndonjë përdorim apo qëllim. Verifikimi i përshkrimit dhe gjendjes së të gjithë njësive të listuara këtu është përgjegjësi e ofertuesit.

Njësia nr.04: Pasuria Bujqësore Toka në Sojeve (Lot B) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 20769m² (2ha 07ari 69m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Sojeve në Komunën e Ferizajit, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 10,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: N.Sh. „Pasuria Bujqësore“ Ferizaj Fi-650/89

Njësia nr.05: Plantacioni Toka në Lloshkobare (Lot A) - ofron për shitje tokën bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 15914m² (1ha 59ari 14m²), në ZK dhe në afërsi të fshatit Lloshkobare në Komunën e Ferizajit, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 10,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: N.Sh. Plantacioni Ferizaj Fi-6544/92

Njësia nr.07: Agromorava Toka në Viti (Lot B) - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej 2561m² (25ari 61m²), në ZK dhe Komunën e Vitit, e cila është e përshtatshme për veprimtari bujqësore. **(Depozita e ofertës: € 7,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: N.B.I.Q. "Agromorava" Vitina Fi-229/89

Njësia nr.09: NSH Produkt Parcela 871-1 në Klinë e Epërme - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe prej 6960m² (69ari 60m²), në ZK Klinë e Epërme, Komuna e Skenderajit. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: NSH Produkti - Skenderaj Fi-727/89; Fi-8163/92; Fi-2694/94; Fi-140/95; UNMIK reg.nr. 80483651

Njësia nr.10: NSH Produkt Toka bujqësore në Prekaz i Epërm 1 - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe 29553m² (2ha 95ari 53m²), në ZK Prekaz i Epërm, Komuna e Skenderajit. **(Depozita e ofertës: € 10,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: NSH Produkti - Skenderaj Fi-727/89; Fi-8163/92; Fi-2694/94; Fi-140/95; UNMIK reg.nr. 80483651

Njësia nr.11: NSH Produkt Toka bujqësore në Prekaz i Epërm 2 - Kjo shitje ofron tokën bujqësore me sipërfaqe 98113m² (9ha 81ari 13m²), në ZK Prekaz i Epërm, Komuna e Skenderajit. **(Depozita e ofertës: € 20,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: NSH Produkti - Skenderaj Fi-727/89; Fi-8163/92; Fi-2694/94; Fi-140/95; UNMIK reg.nr. 80483651

Njësia nr.12: NSH Trepça Hoteleria Lokali i përkohshëm në Mitrovicën Veriore - Kjo shitje ofron lokalin e përkohshëm me sipërfaqe prej 19.7m² sipas Vendimit të Komunës së Mitrovicës nr. 351/495, ndërsa sipas matjeve në terren sipërfaqja është 17m². Lokali gjendet në rrugën Kralj Petar I p.n., në Mitrovicë Veriore. Lokali aktualisht është në qiradhënjë. **(Depozita e ofertës: € 5,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: N.SH. "Trepça Hoteleria" - Fi-603/89; S.H.A. "Fenix" Mitrovicë e Titos Fi-1225/91
N.SH. "King Kompany" Mitrovicë e Kosovës Fi-1638/96; Regjistrimi i UNMIK-ut 80099657

Njësia nr.13: NSH LUX Lokali Biserka në Mitrovicën Veriore - Kjo shitje ofron lokalin afarist me sipërfaqe prej 64m² sipas listës së asetëve, ndërsa sipas matjeve në terren, sipërfaqja është 61.83m². Lokali gjendet në katin përdhës të një objekti banimi në rrugën Kralj Petar I, në Mitrovicë Veriore. Lokali aktualisht është në qiradhënjë. **(Depozita e ofertës: € 9,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: N.Sh. "Lux" Fi-200/89; Fi-6273/92; UNMIK regj.nr. 80038216

Njësia nr.14: NSH LUX Vetëshërbimi 8 marsi në Mitrovicën Veriore - Kjo shitje ofron vetëshërbimin me sipërfaqe prej 245.33m² e përcaktuar sipas matjeve në terren, ndërsa sipas listës së asetëve sipërfaqja është 200m². Lokali gjendet në katin përdhës të një objekti banimi në rrugën Kralj Petar I, në Mitrovicë Veriore. Lokali aktualisht është në qiradhënjë. **(Depozita e ofertës: € 20,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: N.Sh. "Lux" Fi-200/89; Fi-6273/92; UNMIK regj.nr. 80038216

Njësia nr.15: Toka në Dashinoc 3 - përfshinë parcelat nr. 607, 608, 609 dhe 610 me sipërfaqe totale 4ha 15ari 78m² (41578m²) që ndodhen në ZK Dashinoc, Komuna Deçan. Prona ka qasje në rrugë publike. **(Depozita e ofertës: € 14,000)**

Njësia nr.16: Parcela nr. 293 në Dashinoc - përfshinë tokën me sipërfaqe prej 3ha 27ari 43m² (32743m²) në ZK Dashinoc, Komuna Deçan. Prona ka qasje në rrugë publike lokale. **(Depozita e ofertës: € 12,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: KB "Deçani", Deçan Fi-172/81, Fi-225/84

Njësia nr.17: Tokë Bujqësore në Damjan 1 - përfshinë parcelat nr. 989-0, 990-0, 991-0 me sipërfaqe të përgjithshme 5ha 56ari 95m² (55695m²) në ZK Damjan, Komuna Gjakovë. Prona ka qasje në rrugë publike. **(Depozita e ofertës: € 20,000)**

Njësia nr.18: Toka Bujqësore në Damjan 2 - përfshinë parcelat 1213-0, 1214-0, 1215-0, 1217-0 dhe 1525-0 me sipërfaqe të përgjithshme 9ha 14ari 23m² (91423m²) në ZK Damjan, Komuna Gjakovë. Prona ka qasje direkte në rrugë publike. Pjesë e parcelës 1213-0 është e punuar, nuk ka ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e pronës. **(Depozita e ofertës: € 30,000)**

Njësia nr.19: Toka Bujqësore në Damjan 3 - përfshin parcelat nr. 330-0 dhe 331-0 me sipërfaqe të përgjithshme 3ha 53ari 35m² (35335m²) në ZK Damjan, Komuna Gjakovë. Prona ka qasje në rrugë publike. Nuk ka ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e pronës, ajo është e rrethuar me tel. **(Depozita e ofertës: € 15,000)**
Emrat e mëparshëm dhe Fi numrat: KB "Rogova", Rogovë, Gjakovë

Njësia nr.20: Parcela nr. 311 në Ujmirë - përfshin parcelën nr. 311-0 me sipërfaqe 5ha 16ari 03m² (51603m²), kultura arë kl. 3, në ZK Ujmirë, Komuna Klinë. Prona nuk ka qasje në rrugë publike. **(Depozita e ofertës: € 15,000)**

Njësia nr.21: Parcela nr. 511 në Ujmirë - përfshinë parcelën nr. 511-0 me sipërfaqe 1ha 76ari 01m² (17601m²), në ZK Ujmirë, Komuna Klinë. Prona ka qasje në rrugë publike. **(Depozita e ofertës: € 8,000)**
